



KUVENDI I KOMUNËS

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 23 shtator 2019, në mbledhjen e XXIII (njëzetetë) të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

Mbledhja filloi në orën 10;15 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët e Kuvendit të Komunës (Lista e nënshkrimeve), përveç znj.Floretë Zejnullahu e cila mungoi,

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, Drejtorët e Drejtorive, përfaqësues të mjeteve të informimit, një numër i qytetarëve dhe zyrtarëve komunal.

Rendi i Ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke iu dëshiruar mirëseardhje të gjithë të pranishmëve dhe duke i njoftuar rreth pikave të rendit të propozuar të ditës dhe rekomandimeve nga mbledhja e KPF-së e mbajtur më 20.09.2019. Kërkoj nga të pranishmit të marrin fjalën nëse ka të interesuar, nëse jo e hedh në votim rendin e propozuar të ditës sipas materialit përkatës të dërguar dhe konstatimeve nga mbledhja e KPF-së.

Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës sipas materialit të dërguar dhe konstatimeve nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 20 shtator 2019.

1. Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 29 korrik 2019

Njëzëri, u miratua Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, e mbajtur më 29 korrik 2019

2. Propozim vendimi për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2020 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2021 – 2022

z.Isuf Latifi, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, e paraqiti fjalën hyrëse lidhur me propozim buxhetin e Komunës për vitin 2020 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2021 – 2022, ndër të tjera theksoi, marrë për bazë Ligjin për vetëqeverisje lokale, Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit, Statutin e Komunës dhe Qarkoret buxhetore të Ministrisë së Financave si dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore të miratuar në këtë Kuvend, paraqes para Juve projektbuxhetin e Komunës për vitin 2020 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2021-2022, të përcaktuar sipas kufijve final përmes qarkores buxhetore 2020/02 të MF-së, sipas të cilës buxheti i Komunës së Podujevës për vitin 2020 është 24,086,269.00€, strukturë kjo e cila përbëhet prej dy burimeve, granti qeveritar me shumën prej 22,669,708.00€ dhe nga të hyrat vetanake komunale 1,416,561.00€.

granti qeveritar është ndarë në këtë formë; -Administratë komunale, 8,870,670.00€, -Arsim para fillor, fillor dhe arsim i mesëm, 10,860,367.00€, -Shëndetësi 2,038,671.00€, e që në total granti qeveritar është 22,669,708.00€, e që siç po vërehet arsimi është shpenzuesi më i madh i buxhetit nga granti qeveritar. Drejtorja e Arsimit, Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Qendra për Punë Sociale, janë të financuara nga granti i përgjithshëm i administratës komunale. Të hyrat vetanake të planifikuara sipas administratës 1,206,551.00€; të hyrat nga shëndetësia 112,000.00€ dhe të hyrat nga arsimi 98,000.00€.

Ky projektbuxhet është shpërndarë sipas instruksioneve të Ministrisë së Financave dhe atë në kategoritë ekonomike përkatëse, si; -paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione, kapitale, dhe atë si vijon; -Administrata komunale, paga dhe mëditje 2,293,322.00€, mallra dhe shërbime 1,277,103.00€, shpenzime komunale 235,000.00€, subvencione 670,050.00€, dhe kapitale 5,661,106.00€. -Shëndetësi, paga dhe mëditje 1,928,458.00€, mallra dhe shërbime 465,283.00€, shpenzime komunale 50,000.00€, subvencione 60,000.00€, shpenzime kapitale 566,950.00€. -Arsimi, paga dhe mëditje 9,708,211.00€, mallra dhe shërbime 545,735.00€, shpenzime komunale 130,000.00€, subvencione 40,000.00€, shpenzime kapitale 534,419.00€.

Përmbledhje e të gjitha këtyre shpenzimeve totale të ndara sipas kategorive ekonomike janë si vijon; -paga dhe mëditje 13,929,991.00€, -mallra dhe shërbime 2,318,773.00€, -shpenzime për komunal 415,000.00€, subvencione 660,000.00€, -kapitale 6,762,455.00€ e që në total buxheti është 24,086,269.00€, buxhet ky i cili mund të ndahet në dy pjesë, dhe atë, shpenzime operative 17,323,814.00€ dhe shpenzime komunale kapitale 6,762,455.00€.

Vlen të theksohet se te shpenzimet operative, kategoria paga dhe mëditje përmban shumën më të lartë mirëpo edhe te kategoria e subvencioneve kemi ndarë një shumë të theksuar apo maksimumin e shumës së lejuar sipas Qarkores Buxhetore 2020/02 dhe atë 40,000.00€ për bursa, 60,000.00 € për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, 100,050.00€ për kulturë rini dhe sport si dhe 346,350.00€ për bujqësi. Të nderuar, Ministria e Financave me rastin e caktimit final të buxhetit për kategori ekonomike ka bërë shkurtime te kategoria e investimeve kapitale në shumë prej 300,582.00€ dhe te kategoria paga dhe mëditje në shumë prej 83,990.00€ nëse krahasohet me KAB të miratuar në qershor, ndërsa janë rritë kategoria mallra dhe shërbime, në shumë prej 504,657.00€, dhe komunalitë në shumë prej 9,764.00€. Në takimin që kemi pasur me zyrtarët e Ministrisë së Financave kemi kërkuar mjete shtesë për kategorinë paga dhe mëditje, dhe këtë duke u bazuar në ligjin për paga i cili pritet të filloj implementimin, kurse në kategoritë tjera kemi sugjeruar që planifikimet të mbeten ato që janë të miratuara me KAB.

Në materialin e dërguar keni parë edhe listën e projekteve kapitale të planifikuara për vitin 2020 dhe prioritetet për vitet 2021-2022, e që kemi pas parasysh një shtrirje të gjerë territoriale të Komunës së Podujevës duke u munduar t'i plotësojmë sa më shumë të jetë e mundur nevojat dhe kërkesat e qytetarëve, por duke pasë parasysh edhe që nevojat dhe kërkesat e tyre janë shumë më të mëdha, mirëpo buxheti i ndarë nuk na mundëson të bëjmë më shumë, por shpresojmë që propozimet janë të arsyeshme. Me këto prioritetet kemi paraparë të ndërtojmë rrugë, kanalizime, kolektor, trotuare, rrjetë të ujësjellësit, ndërtim të objekteve shëndetësore, arsimore etj. Të nderuar projektbuxheti është një prej dokumenteve më të rëndësishme që miraton ky Kuvend dhe që është direkt i lidhur me qytetarët e Komunës së Podujevës, prandaj ju ftoj që ta shqyrtoni dhe miratoni sipas këtij propozim vendimi.

z.Avni Fetahu, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e LDK-së, edhe në mbledhjen e KPF-së i kemi dhënë rekomandimet dhe sugjerimet tona lidhur me projektbuxhetin e Komunës për vitin 2020 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2021-2022, andaj edhe si të tillë e përkrahim dhe do ta votojmë.

Buxheti i Komunës është vërejtur dhe do të duhej të planifikohej, të hartohet dhe zhvillohej në atë mënyrë që ti mbuloj kërkesat dhe prioritetet e përcaktuara në Planin Zhvillimor Komunal duke i mbuluar edhe zonat gjeografike, me theks të veçantë duke i eliminuar deficitin ose suficitin e mundshëm në fund të vitit. Për fund, është e rëndësishme të potencohet se transparenca duhet të përcillet nga fillimi i përgatitjes së projektbuxhetit deri tek realizimi i tij, e që me këtë do të rritej edhe besimi i qytetarëve edhe ndaj Komunës por edhe ndaj Ekzekutivit.

z.Fitim Haziri, theksoi, buxheti për vitin 2020 është në vazhden e logjikës së mbrapsht të konceptit zhvillimor të kësaj qeverisje të paaftë komunale, edhe pse me rritje nga viti në vit nuk po përdoret nga qeverisja komunale për të arritur objektivat si; rritja e punësimit, rritja e prodhimit, politikat ambientale, urbanizmi etj, por që, nga paslufta buxheti kryesisht orientohet në asfalt të dobët, në rrugë të cilat asfaltohen shpesh e që nuk rregullohen kurrë. Si duket dikush ka interes sepse përndryshe nuk ka logjikë të shëndosh që kupton këtë punë, Ne si LVV, po na bie ti përsërisim vërejtjet tona jo për fajin tonë por për arsye se ju si pushtet po i bëni gabimet e njëjta. Komuna e Podujevës nuk i posedon dokumentet themelore të cilat e orientojnë zhvillimin komunal, si Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal, Planin Urbanistik, Strategjinë sektoriale, si atë të arsimit, shëndetësisë, bujqësisë, dhe rrjedhimisht kur nuk janë këto dokumente buxheti mund të planifikohet në mbështetje të arritjes së objektivave të pa paraqitura në ato dokument, por një buxhet ad-hoc, pak asfalt aty, pak trotuar, disa kanalizime e në fund përfundojmë këtu ku jemi sot, një Komunë e pazhvilluar, me kaos urbanistik, arsim të dobët, shërbime shëndetësore jo të mira, etj. Nga buxheti total prej 24,086,269.00€, për investime kapitale të parapara 6,752,455.00€ ku pjesa dërrmuese shkojnë në asfalt, ne si LVV për shkak të kësaj logjike të prioritetit të këtyre politikave jemi kundër këtij propozim buxheti. Nëse në këtë propozim inkuadrohen këto propozime tona, ne do ta votojmë këtë buxhet, propozimet tona janë;

-investime për ngritjen e një zone ekonomike në vlerë prej 500,000.00€, e keni pasë në plan qysh më përpara por asnjëherë nuk u bë, -pastaj duke e parë gjendjen e rëndë të objekteve infrastrukturore, propozojmë të ndahen buxhetet shtesë prej 600,000.00€, -buxhet shtesë për kabinete të laboratorëve të shkollave, -ndarjen e fondit prej 500,000.00€ për mbështetjen e biznesit prodhues, fond ky i cili do të përdoret për subvencionimin e normave të interesit për kredi investive që financohen për zgjerimin e kapaciteteve prodhuese, -ndarjen e fondit prej 300,000.00€ për grante në bujqësi, -ndarjen e fondit shtesë prej 100,000.00€ për renovimin e objekteve shëndetësore.

Pra ne si LVV e votojmë këtë propozim buxhet veç nëse këto mjete prej 2.2 milion euro alokohen në projekte që i propozuam. Ndoshta Drejtori i DBF do të thotë që *(sikur t'i kishim pas nja 10 milion euro do t'i kishim kryer)* mirëpo mos harroni se ju kanë tepruar mjetet buxhetore më shumë se 2 milion euro e që nuk keni ditë çka të bëni.

z.Rafet Llapashtica, fillimisht ju uroj suksese të gjithë kandidatëve që janë pjesë e listave zgjedhore për Zgjedhjet e Përgjithshme për Deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke shtuar që Podujeva në të ardhmen të ketë përfaqësuesit e vet në Kuvendin e Republikës së Kosovës në mënyrë që duke qenë të unifikuar t'i qojmë proceset përpara.

Lidhu me këtë pikë, theksoi, edhe në mbledhjen e KPF-së kemi diskutuar për këtë dokument kaq të rëndësishëm i cili do të jetë në opsion për 3 vitet e ardhshme sa i përket investimeve në Komunën e Podujevës dhe planifikimeve të Ekzekutivit të Komunës. Dëshiroj të ngriti sërish në Kuvend atë që të gjitha subjektet kemi diskutuar me Drejtorin e DBF z.Isuf Latifi, që në këtë dokument, te pagat dhe mëditjet ka mungesë të buxhetit duke marrë parasysh që në muajin dhjetor të këtij viti hyn në fuqi Ligji për pagat i cili parasheh ngritje të pagave, sa e kam kuptuar atë që Drejtori e ceku është se ka mungesë të buxhetit rreth 80,000.00€ dhe duke parashikuar Ligjin në fjalë i cili prek edhe pjesën e Kuvendit, do të thotë është një shqetësim i cili në një formë ceket në propozim vendim, neni 4, thuhet që do të rregullohet me nivelin qendrorë, mirëpo të paktën ky dokument miratohet dhe Komuna e Podujevës punon me këtë, andaj mbetet sa do të jetë në gjendje niveli qendrorë ta zgjidh këtë problem. Te projeksionet e parashikuara nga Ekzekutivi për vitet 2020, 2021, 2022 më bëri përshtypje infrastruktura, tek rrugët dhe asfaltimi i tyre ku asnjë investim i kësaj natyre nuk është specifikuar me emër dhe lokacion por vetëm është specifikuar me toponim të përgjithshëm e që është e pa pranueshme sepse besoj që të gjitha Grupeve të këshilltarëve ju janë bërë pyetje sidomos në këtë kohë fushate qytetarët janë shumë të interesuar të dinë targetimet, shembull shtrojnë pyetje se cila rrugë do të asfaltohet, të paktën unë nuk kam mund t'ju jap përgjigje sepse behet fjalë për 3 vite dhe ata pyesin se cilat janë prioritetet. Më parë sa nuk kemi pas toponime apo emra të rrugëve ka qenë ndryshe shembull me lagje, mirëpo tani i kemi emrat e rrugëve dhe është dashtë të specifikohen fshatrat dhe emrat e rrugëve duke përfshirë edhe gjatësinë dhe gjerësinë si dhe çdo paramasë tjetër nëse dëshirojmë të jemi të ndërgjegjshëm para qytetarëve. E vërejta edhe mos mundësinë dhe bartjen e buxhetit për 3 vite rresht të realizimit të projektit për Bulevardin e Dëshmorëve me shumën mbi 1 milion euro, dokument të cilin e kanë para vetës gjithë këshilltarët, projekt ky i cili është dashur të kryhet para 3 viteve dhe tani është bartur në vitin 2020, nuk ka pasë nevojë të barten ose është dashur të futen në funksion deri tani, jemi në dijeni edhe për suficidin buxhetor të Komunës nga viti i kaluar që nuk është shpenzuar, jemi në dijeni edhe për një takim të mbajtur nga Kryetari i Komunës me kryetar të komiteteve të fshatrave, kryetar të cilët janë politik dhe ka pas kërkesa të gjitha subjektet politike në mbledhjen e parafundit të KPF, dhe ka qenë pëlqim edhe i vetë subjektit që është në pushtet që të jetë pikë e rendit të ditës agjenda e themelimit të kryetarëve të komiteteve të fshatrave, ku me ligjin e ri është hyrë në funksion dhe është rregulluar që kryetarët e komiteteve të fshatrave të mos jenë persona politik dhe anëtarë të partive politike, çështje kjo e cila nuk është sjellë në rend dite, andaj do të ishte mirë të futej sot në pikën të ndryshme, në mënyrë që në këtë kontekst edhe Kryesuesi i Kuvendit edhe personalisht të merrej me këtë sepse ka qenë edhe ky për, që kjo agjendë të jetë në këtë mbledhje. Mandej në bazë të procesverbalit kam vërejtur edhe kryetar politik të fshatrave e që e ka cek një kryetar i cili më ka bërë shumë përshtypje, fjala është për atë të fshatit Bellopojë i cili në atë takim ka thënë që ne nuk kemi asnjë kërkesë për fshatin tonë sepse është punuar shumë dhe nuk kemi kërkesa, mirëpo nëse nuk e ka asnjë kërkesë mund të themi se është deklaratë zyrtare e kryetarit të komitetit të fshatit që në

takim me institucionin, në emër të të gjithë atyre banorëve nuk ka asnjë kërkesë, por mund ta kenë të tjerët, prandaj në këtë dokument për vitet 2020-2022 nuk është përfshirë asnjë projekt, madje problem ka edhe vet institucioni për të kaluar rrugën e atij fshati sepse në fillim të hyrjes në fshat - në drejtim të Xhamisë, sepse është shemb dheu dhe është dashtë të intervenohet me të hyrat vetanake dhe të rregullohet, unë nuk jam nga ai fshat por vetëm kaloj andej dhe është gjendje e tmerrshme, por kalojnë të gjithë pothuajse, madje tani po lëvizin të gjithë sepse është fushatë dhe mbajnë takime të ndryshme në fshatra të ndryshme, kështu që është jo e sigurtë, pra duhet të jemi të kujdesshëm. Vërejtja se në vitin 2020 janë ndarë vetëm 40,000.00€ për ndërtimin e një pende me kanale të ujitjes për bujqësi e që mendoj se është e papranueshme dhe për analizat e tokës e që mendoj se me një shumë prej 20,000.00€ për ngritjen e një pende janë shumë pak dhe do të doja ta dija ku do të ndërtohet ajo pendë, në cilën pjesë së bashku me kanalet e ujitjes, por që shuma është e pamjaftueshme madje është ndarë vetëm sa për të thënë se kemi ndarë, e që të jemi të sigurtë se nuk do të mund të ndërtohet me atë shumë, pastaj ne kemi edhe në qytet pjesë që nuk e kanë rrjetin e ujit të pijes. Po ashtu vërejtja shumë prej 80,000.00€ në Drejtorinë e cila merret me parqe dhe hapësira publike, nuk ka rregullim të hapësirave publike në Podujevë dhe nuk ka intervenim në parqe në Podujevë madje nëse ndokush mund të thotë se është bërë ndonjë intervenim në parqe dhe hapësira publike dhe që ka ndryshuar diçka Podujeva qe 19 vite, më thonë. Unë edhe më parë i kam shtruar pyetje Nën kryetarit të Komunës dhe direkt Kryetarit, sa pemë dhe hapësira publike i keni mbjellë/rregulluar, përveç disa luleve që mbjellën në disa vende siç është në afërsi të objektit Beni Dona, të cilat kushtojnë nga 50 cent kurse faturimi bëhet 4,500.00€ deri në 7,000.00€, dua të them se Podujeva nuk e ka asnjë park përveç pjesës këtu afër Komunës, e që janë 20 vite shpenzim buxheti nga kjo Komunë kurse hapësira publike dhe parqe nuk ka. Unë e mbështes këtë shumë madje jam edhe që të rritet sepse është në interes të të gjithëve, por kërkoj prej Drejtorit kompetent të dijë cili është parku që do të ndërtohet me këto 80,000.00€ konkretisht, sepse ne do ta votojmë këtë buxhet dhe pa marrë përgjigje konkrete nuk mundemi ta votojmë sepse nuk dimë çka. Tek shëndetësia mendoj se është në rregull ndarja e buxhetit, madje duhet t'i gëzohemi ndërtimit të objektit të ri të QKMF-së që do të ndërtohet tek ish tregu i kafshëve dhe që ajo pjesë paksa do ta shkarkoj qytetin, pastaj i gëzohemi edhe kërkesës së SHSKUK-së për dhënie të pronës në shfrytëzim për ndërtimin e spitalit të ri e që do ta votojmë, mirëpo faktikisht dokumenti si dokument i nderuar Kryesues po na vie vetëm bllanko, edhe pse goxha e shtjelloj, i di edhe takimet që mbahen në për fshatra, i di edhe ato kërkesa që kanë qenë për të intervenuar dhe që është thënë mos intervenoni sepse është i një subjekti tjetër politik, mirëpo të paktën të gjithë jemi qytetarë të Podujevës dhe gjithë ata që jetojnë nuk mund të jenë vetëm nga një subjekt politikë, të paktën të gjithë kemi qenë dhe e kemi luftuar bashkërisht komunizmin ku nëse ndokush mendon diçka duhet të mendoj i gjithë shteti, prandaj mendoj se duhet të hiqet prej mendje nga cilido subjekt që ashtu siç mendon ai ashtu duhet të mendoj i gjithë Llapi, dua të them se është e papranueshme një gjë e tillë siç është ndarja parcale, tendenca për një qytetar që ndoshta për të arritur diçka duhet intervenim, nëse doni jua përmend edhe me emër ku zyrtarët komunal intervenojnë në ndarjen subvencioneve qoftë këtu brenda, qoftë nga qendra ku për shumë prej 120,000.00€ për grante në bujqësi, i thuhet qytetarit që nëse donë të shpallësh fitues duhet të futesh në funksion 60,000.00€ kurse 60,000.00€ tjera shkojnë nëpër gjepa të njerëzve, nuk do ta përmendi në këtë mbledhje por në mbledhjen e radhës do të përmend me emër e mbiemër edhe qytetarin edhe zyrtarin. Kështu që për Drejtorinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e cila bënë ndarje të subvencioneve në dimër për sistemin e ujitjes pikë – pikë për fermerët, pra të votojmë buxhet për këtë Drejtori nuk mundemi. Andaj kemi vërejtjet tona në projeksionet e përgatitura, ndoshta nuk

kanë pas kohë Drejtorët sepse është kohë fushate zgjedhore, por nëse ndokush mundet të më thotë, përfshirë edhe këshilltarët e Kuvendit të cilët secili vijmë nga shumë zona të territorit të Komunës së Podujevës, secili për fshatin e vet ku është përmend, që cila rrugë do të asfaltohet në vitin 2020, konkretisht ata nga LDK-ja, unë personalisht do ta votoj këtë projektbuxhet, pra në cilindo fshat i cili është i përfshirë në këtë dokument, të më thotë ndokush që kjo apo ajo rrugë do të asfaltohet duke përmend edhe emrin e rrugës, lagjen, koston, unë do ta votoj para atij këshilltari sepse nuk jemi për të penguar projektet por duhet të jemi në dijeni se çka ka në këtë dokument. Pres ndonjë përgjigje konkrete ose të paktën prej krejt projeksioneve të infrastrukturës të përmenden vetëm 3 rrugë se ku do të investohen, pastaj do të diskutojmë se çfarë do të bëjmë.

z.Bajram Ajeti, theksoi, dëshiroj të jem shumë i shkurtër, megjithatë kam disa shqetësime për t'i paraqitur dhe fillimisht po i drejtohem Drejtorit të Drejtorisë së planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit z.Hamdi Jaha i cili më 31 maj 2019 ka thënë se rruga "Zahir Pajaziti" do të kryhet për 1 muaj e 20 ditë, kurse tani jemi në muajin shtator dhe ende nuk ka përfunduar. Çështja tjetër që dua ta trajtoj është ajo që edhe parafolësi e ceku se nuk po intervenohet në parqe, unë mënoj se po intervenohet dhe atë mund ta shihni se Beni Dona për çdo ditë po zgjerohet duke shtruar trotuar, me leje a pa leje nuk e di por është punë e cila po shihet nga të gjithë qytetarët, pra po ka intervenime për të keq, me uzurpime etj etj.

Edhe njëherë dëshiroj të ngriti çështjen e rrugës në fshatin Llapashticë te Lagja Cakiqi në drejtim të shkollës, jam në dijeni se jeni takuar me përfaqësuesin e asaj lagjeje dhe keni bërë biseda dhe i keni premtuar që do të përfshihet ajo rrugë në buxhetin e vitit 2019, është fakt se mos përcaktimi detaj të secilës rrugë, meqë kemi emërtimet e rrugëve në gjithë vendin, por qoftë edhe lagje të caktuara, është e domosdoshme të specifikohen, e them këtë ngase ju po lëni mundësi që në ndonjë fshat të caktuar pastaj të motivuar politikisht të mos asfaltohet rrugë të caktuara dhe për këtë ka shembuj që besoj se ju e dini këtë sepse i hulumtoni se me cilin subjekt janë ata banorë. Pra këtu kemi projektin, asfaltimi i disa rrugëve në Llapashticë, andaj shtroj pyetje a është në planifikime rruga e cekur të cilën ia keni premtuar apo jo.

Çështja tjetër, përderisa çdo rrugë e asfaltuar, siç ishte një fjali e paraluftës se çdo rrugë e asfaltuar të dërgon në rrugë të funksionarëve, gjë e cila vërehet edhe në këtë fushat se ai që ka pushtetin dhe mundësin i asfaltton rrugët deri te fqinjët, miqësia etj, andaj përse fshati Repë nuk është në planifikime për asfaltimin e asaj rrugë rreth 900 m, dhe e cila dërgon deri te Dëshmori i UÇK-së Enver Rustemi, përse ajo rrugë dhe ai fshat nuk është në planifikime me ndonjë projekt, e që po ta marrim si shembull fshatin Bradash ku edhe rrugët e arave janë shtruar me asfalt, përse ajo rrugë e fshatit Repë të mos asfaltohet, kështu që mendoj se njëherë tjetër duhet të përfshihet rruga e cekur, edhe pse sot nuk do ta votojmë këtë propozim buxhet sepse mbetemi pran propozimeve tona si Grup i këshilltarëve të LVV-së ngase janë në interes të drejtpërdrejtë të qytetarëve, andaj mendoj se duhet të kemi një respekt të parimeve dhe të trajtimit të barabartë ndaj qytetarëve.

znj.Mrika Thaqi, theksoi, ne jemi shumë të vetëdijshëm se nevojat e qytetarëve janë të mëdha dhe prej më të ndryshmeve, por bazuar në faktin se disa prej propozimeve tona janë përfshirë në këtë propozim buxhet, edhe përkundër vërejtjeve që mund t'i kemi, ne do ta votojmë këtë propozim buxhet sipas materialit përkatës.

z.Arbër Blaku, theksoi, e kam shfletuar këtë dokument propozim buxhet, njëmend është e paqartë kjo çështja e shpenzimeve për rregullimin e hapësirave publike sepse nuk specifikohen vendet dhe nuk e dimë ku dhe çka. Unë e kam një kërkesë specifike të banorëve të qytetit, dhe i

drejtohem në formë të pyetjes Drejtorit të Drejtorisë kompetente z.Faik Muçiqi, konkretisht për rregullimin e banesave publike që nga ato që janë në afërsi të spitalit deri te parku këtu afër.

Sa jam i informuar, përveç në dy objekte që është intervenuar paksa, asgjë nuk është bërë në këtë drejtim deri tani, ndërsa po ti shohim ato banesa janë pothuajse në mjerim. Nëse më premtan Drejtori i cekur se në vitin 2020 do të rinovohen ato objekte unë do të jap votën këtij propozim buxheti.

z.Adnan Zymeri, theksoi, analiza, diskutimi dhe votimi i dokumentit më të rëndësishëm që trajtohet në Kuvendin e Komunës përbën vendimin më të rëndësishëm të vitit legjislativ. Buxheti definohet edhe si vlerësim për të ardhurat dhe shpenzimet për një kohë të caktuar, në rastin tonë edhe si pasqyrim i projekteve me ndikim për qytetarët tanë.

Ndërtimi i shkollave të reja, plotësimi i kërkesave infrastrukturore, zgjerimi i rrjetit të ambulancave të mjekësisë familjare, intervenimi në përmirësimin e infrastrukturës bujqësore, ndërtimi i hapësirave rekreative për të rinj janë disa nga kërkesat të cilat gjejnë mbështetje në vlera të caktuara brenda këtij buxheti. Përkundër kësaj nga një vlerësim i përgjithshëm shtrohet pyetja se a u përgjigjet në nivele të mjaftueshme ky planifikim qytetarëve tanë, patjetër që jo, ngase ka edhe nevoja të tjera të cilat do të kenë mundësi të plotësohen pas 6 tetorit kur do të kthehet vëmendja e merituar për qytetarët llapjan.

z.Mirsad Kamerolli, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik – DPZHE, theksoi, Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal, për periudhë tri vjeçare veç është në fazën përfundimtare dhe shpresoj se në seancën e ardhme do të del për shqyrtim dhe miratim në këtë Kuvend, sa i përket zonës Ekonomike, ne si Komunë dhe si Drejtori që jemi kemi bërë atë që ka qenë e mundur në fushën dhe domenin tonë, fatkeqësisht çështja e pronës është problem dhe për këtë nuk kemi mund të fillojmë të punojmë diçka në këtë drejtim, mirëpo angazhimi jonë ka qenë në drejtim të duhur, por këtu e këndeje varet nga Gjykata Kushtetuese me vendimin përfundimtar që do ta nxjerr, dhe në atë moment që kjo gjykatë nxjerrë vendim sipas të cilit prona përkatëse i kthehet Komunës, ne do të zhvillojmë procedurat tjera përkatëse. Andaj ne si Komunë nuk kemi në dorën tonë më asgjë pa pasur një definim të qartë të pronës.

Sa i përket fondit për mbështetje të bizneseve prodhuese, është e vërtetë se duhet të planifikojmë buxhet në periudha të mëvonshme sepse tani për tani jeni në dijeni se buxheti është i limituar, mirëpo një gjë e di se nuk ka biznes prodhues apo tregtar i cili nuk është i pajisur me infrastrukturë, me këtë buxhet që ka pasë Komuna, kështu që edhe në këtë drejtim shpresojmë se do ta rrisim asistencën dhe mbështetjen financiare në vitet në vijim.

Ne projektet tona i kemi në bazë të buxhetit të caktuar që është për kategori të caktuara buxhetore të Komunës dhe që nuk është i mjaftueshëm, po ti marrë parasysh projektet e DPZHE do të doja që buxhetin dërmues të orientohej në këtë Drejtori, por në periudhën e vitit 2020 i kemi vetëm 120,000.00€ me shpresë se do të definohet çështja e zonës ekonomike, dhe në çoftë se ndodh kjo atëherë duhet të planifikojmë buxhet shtesë në këtë drejtim.

z.Faik Muçiqi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSh, theksoi, me vëmendje dëgjova vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet e juaja për çka edhe ju falënderoj. Lidhur me procesin e përgatitjes së këtij propozim buxheti kemi filluar bukur herët dhe kemi mbajtur disa debate me qytetarë edhe me ju si Kuvend kur është miratuar KAB. Sa i përket DSHPMSh, jemi munduar të përfshijmë në këtë projektbuxhet të gjitha propozimet e dhëna pavarësisht nga kanë ardhur, buxhet ky i cili në raport me Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit është më i vogël sepse kjo Drejtori ka paraqitur kërkesa më të shumta që kryesisht buxheti të jetë i orientuar në punë dhe projekte të qytetit. Ky projektbuxhet ka një strukturë të ndryshuar që tani po kalon nga ndriçimet publike, urat dhe rregullimi i lumit Llap

kryesisht, që të vazhdoi me gabione dhe mure mbrojtëse nga fshati Lluzhan deri në qytetet dhe nga viti i ardhshëm edhe në pjesën e epërme të rajonit.

Disa nga këshilltarët paraqiten kërkesa, përjashtuar kërkesën e Grupit të LVV-së e cila e paraqet një strukturë tërësisht të ndryshme të buxhetit që tani Drejtori i DBF sigurisht do të jap përgjigje, mirëpo për mua është e papranueshme të ndërrohet struktura e parapërcaktuar nga Ministria e Financave mirëpo këto janë politika të tyre që ne nuk mundemi t’jua mohojmë por sa janë të pranueshme në bazë të ligjeve në fuqi mbetet të analizohet ngase një strukturë tërësisht e ndryshuar e buxhetit të kaloj në subvencione dhe mallra dhe shërbime është çështje tjetër.

Sa i përket asaj që këshilltari z.Rafet Llapashtica e tha se disa prej përfaqësuesve të fshatrave nganjëherë nuk paraqesin kërkesat dhe projektet e tyre, mund të them se është krejtësisht normale dhe nuk ka asgjë të keqe, unë kam pas rastin t’i dëgjoj të gjithë përfaqësuesit e fshatrave, dhe t’ju them të drejtën në shumë raste nuk kemi dal as me bindjet e tyre. Për fshatin Bellopojë, meqë u përmend, kemi dy projekte, vazhdimi i trotuarit nga fshati Shakovicë deri në fshatin Bellopojë e që ndoshta fare nuk dalin këto në opinione të ndonjë individi, pra nuk udhëheqim për nga bindjet politike ashtu siç u cek ndoshta sepse buxheti është apartiak andaj edhe jemi munduar të kemi sa më shumë vende dhe natyrisht që prioritetet i bënë Ekzekutivi aty ku mendon se janë prioritetet. Sa i përket pyetjes së këshilltarit z.Arbër Blaku lidhur me rinovimin e objekteve banesore, i them që mund të mos e voton buxhetin fare (sepse ashtu edhe kërkoj) ngase premtim nuk mund të jap, por mund të them se është Ligji për Ndërmarrjet Publike sipas të cilit ekziston Ndërmarrja Publike Banesore në Podujevë, mirëpo edhe pavarësisht kësaj në Komunën e Podujevës kemi probleme me disa banesa, posaçërisht me mbulesat – kulmet e tyre të cilat janë nga asbesti e që nga ky vit një pjesë ta përfundojmë dhe nga viti i ardhshëm iu kam thënë edhe banorëve që posaçërisht kulmet që janë nga asbesti do t’i rregullojmë, kurse për fasade etj, do të shikojmë mundësit se çfarë mund të bëjmë brenda buxhetit që kemi. Janë disa objekte banesore të cilat kanë rrezikshmëri, posaçërisht me kulme, mirëpo unë nuk po jap premtim vetëm sa për ta votuar ndokush buxhetin në këtë rast.

Mendoj që brenda Drejtorisë kemi arritur t’i kemi kërkesat e përgjithshme, vazhdimin e projekteve, gjithnjë brenda mundësive buxhetore, kërkesat janë shumë më të mëdha posaçërisht në aspektin e pastrimit dhe zgjerimit të lumenjve aspektit ambiental të tyre sepse për fat të mirë jemi territor që kemi lumenj të shumtë dhe që është e nevojshme të ndërhyhet me rregullimin e tyre, pastaj kemi kërkesa dhe nevoja të mëdha për ndriçime publike e që nuk është e shtrenjtë kostoja e ndërtimit sa është kostoja e mirëmbajtjes së tyre nga mallra dhe shërbime por gradualisht duke u nisur nga qendra do të shtrijmë edhe në ato pjesë ku e shohim më të nevojshme. Me gjithë këto vërejtje sugjerime dhe qëndrimet sepse buxheti nuk është statik, mendojmë se Qeveria e ardhme e Republikës së Kosovës do të jep mundësi lejin e rishikimeve të buxhetit sepse në këto dy vite nuk ka lejuar dhe si rrjedhojë janë paraqitur shumë probleme sa i përket ri rregullimit të buxhetit dhe projekteve e që do të hapet mundësia që edhe kërkesat tjera që janë në prioritetet t’i përfshijmë në planifikimet tona buxhetore.

z.Arbër Blaku, theksoi, i nderuar Drejtor i DSHPMSh, përgjigje më të vrazhdë politike në jetë nuk kam dëgjuar se ajo që e cekët ju kur e potencuat, mos e voto buxhetin. Singerisht u befasova sepse pak a shumë e njoh Drejtorin parafolës se si funksionon, e them këtë sepse qysh në fillim mu drejtua duke më thënë, mos e voto buxhetin, andaj sugjeroj të lihet vend për diskutime e jo ashtu të prehen gjërat. Sa i përket asaj që u tha se Ekziston Ndërmarrja Banesore etj etj, ato janë vetëm “filma” sepse të gjitha Komunitatet e Kosovës i kanë rinovuar banesat, kurse në Komunën e Podujevës tash e 20 vite nuk ka ndërhyrë askush përveç dy objekteve të tilla, ndërsa nëpër qytete

tjera nuk ka Ndërmarrje Banesore dhe pothuajse të gjitha i kanë rregulluar, andaj nuk qëndron ajo që e potencuat, mirëpo mbetet në vullnetin e juaj politik a doni apo jo të investoni.

Jam në dijeni se tash e 20 vite buxhetin e keni orientuar kryesisht në fshatra, dua të them se qytetin e keni lënë anash, sidomos këto banesa, nuk janë këto deklaramë politike, madje i kam edhe të gjitha peticionet e banorëve dhe do t'jua sjell.

z.Faik Muçiqi, Drejtor i DSHPMSh, sqarim parafolësit, nuk e thash mos e voto buxhetin, mirëpo përgjigja ishte për rastin konkret kur ju kërkuat premtim nga unë që nëse do të realizohet kërkesa do ta votoj buxhetin, pra ka mund të jetë keqkuptim, dhe sërish po e them që nëse bëhet fjalë vetëm për këtë investim, nuk mund të premtoj që do të realizohet në vitin e ardhshëm, pra unë i dhashë sqarimet e nevojshme qoftë për kulmet e objekteve banesore qoftë për pjesë tjera, mirëpo nganjëherë kur dikush është shumë i sinqertë, politikisht mund të del jo mirë.

z.Mirsad Kamerolli, Drejtor i DPZHE, theksoi, përgjigje këshilltarit z.Fitim Haziri, në fakt ne e kemi të paraparë dhe kemi negociuar një marrëveshje me një Organizatë Gjermane dhe me donator tjerë të cilët sigurisht që do të na mbështesin me shumën prej 45,000.00€ ku bashkërisht me Komunën do të zhvillohet një projekt për mbështetjen e ndërmarrjeve private, shpresojmë që do të arrihet ajo marrëveshje në vitin e ardhshëm, andaj për arsye buxheti i DPZHE për vitin 2020 është planifikuar 125,000.00€.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes dhe Mjedisit – DPUMM, theksoi, u paraqiten disa pyetje rreth propozim buxhetit, sidomos në infrastrukturë dhe atë në pjesën e urbanizmit. Fillimisht dëshiroj t'i përgjigjem këshilltarit z.Rafet Llapashtica rreth asaj që e ceku se një përfaqësues i fshatit nuk ka paraqitur kërkesa për fshatin e tij, unë them se ndoshta nuk ka paraqitur kërkesa për shkak se nuk ka pasur projekte në fshatin Bellopojë, e them këtë ngase jo vetëm ky fshat por ashtu sikurse edhe fshatrat tjera janë afërsisht në përfundim e sipër me infrastrukturë, kërkesa dhe nevoja tjera. Në fakt në fshatin e cekur kemi në projekte rrugë të cilat duhet të asfaltohen, përkatësisht është projekt dy vjeçar 2019 -2020 apo 60,000.00€ për këtë vit dhe për vitin e ardhshëm 95,000.00€, kështu që investimet në ato rrugë do të përfundojnë në vitin e ardhshëm. Pastaj lidhur me pyetjen që këshilltari i cekur e shtroj se ku do të investohet, unë do t'i sqaroj vetëm disa prej tyre sepse ka shumë nëse lëshoheni në detaje, ta marrim shembull fshatin Shajkoc, janë disa rrugë që do të asfaltohen e që komplet për tu përfunduar janë 1720 m, prej tyre në vitin 2020 janë planifikuar të asfaltohen rrugët, “Rifat Musolli” me gjatësi 160 m me një buxhet prej 7500.00€, rr.”Ahmet Mehemeti”-te Lagja Mulolli, gjatësia 180 m, në shumë prej 8640.00€, rr.”Jupa Jupolli” gjatësi 280 m, 13440.00€, rr.”Ahmet Mehmeti” gjatësi 300 m, 14,400.00€, e që gjerësia e këtyre rrugëve të lagjeve është 3m eventualisht 4m, sigurish disa prej juve nuk jeni në terren dhe nuk keni shumë informata dhe ballafaqime me qytetarë të lagjeve dhe fshatrave të ndryshme të cilët vijnë paraqesin kërkesa për asfaltim etj, por ku të vie në pyetje zgjerimi, madje vetëm 5cm, pastaj paraqiten shumë probleme sepse nuk dëshirojnë, mandej, është rruga tek lagja Durmishi gjatësi 80 m, buxhet 3840.€, rr.”Muharrem Rudari” me gjatësi 180 m, me një buxhet 8640.00€, pra janë këto rrugë të planifikuara për asfaltim, por janë edhe rrugët e këtij fshati të cilat nuk mund të përfshihen njëherë në planifikime buxhetore, ato janë rr.”Feriz Kosumi” gjatësi 200 m, rr.”Regjep Agushi” gjatësi 200 m e cila do të shtrohet me zhavorr, rr.”Shaban Agushi” gjatësi 160m dhe rruga e lagjes Bekolli me gjatësi rreth 180 m. Pra meqë ky fshat u përmend edhe i paraqita këto të dhëna. Ne si DPUMM për vitin 2020 i kemi 39 projekte duke përfshirë edhe shpronësimin e rrugës së re (përgjatë lumit Llap) për të cilën është nxjerrë vendimi për shpronësim dhe ka kaluar të gjitha fazat procedurale, ku fillimisht është marrë vendim këtu në këtë Kuvend për shpalljen e asaj pjese interes publik, pastaj Ministria e Financave – Departamenti përkatës ka vendosur për

lartësinë e kompensimit – vlerësimit të pjesëve të pronave dhe tani një pjesë e madhe e pronarëve të atyre pronave janë pajtuar me vlerësimin e pronave të tyre, të tjerët nëse nuk pajtohen e kanë mundësinë t'i drejtohen Gjykatës. Me ligj është e rregulluar që kompensimi të bëhet brenda 2 viteve dhe për këtë arsye kemi paraparë buxhet për dy vitet e ardhshme, përkatësisht për vitin 2020 kemi planifikuar 280,000.00€ kurse për vitin 2021 kemi planifikuar 290,000.00€ ku edhe do të përfundoj komplet procedura e pagesës së tyre në emër të kompensimit.

Sa i përket asaj që këshilltari z.Bajram Ajeti e ceku me afatin 1 muaj e 20 ditë për asfaltimin e pjesës së rrugës “Zahir Pajaziti”, ndoshta gabimisht është kuptuar sepse komplet projekti i asaj rruge është dy vjeçar 2018-2019, përkatësisht sipas kontratës afatin e ka deri në dhjetor të këtij viti, kurse nëse i referoheni raportit të Drejtorisë i cili është sjellë në muajin maj, ka qenë raport vetëm deri në atë kohë, por jo edhe afati i përfundimit. Ne e kemi paraparë dhe e kemi cekur se faza e parë është kryer në muajin korrik, ajo pjesë ka rreth 900 m, edhe pse nëpër rrugë të qytetit kemi jashtëzakonisht probleme me komunikacion edhe përkundër vendosjes së shiritave dhe dërgimit të Policëve, një pjesë e qytetarëve vazhdimisht paraqesin pengesa në komunikacion duke lëvizur nëpër ato vende ku realisht janë duke u kryer punime.

Sa i përket rrugës së cekur në fshatin Llapashticë te lagja Cakiqi, edhe pse ju si LVV po thoni mos asfaltoni rrugë, ajo është e paraparë për vitin 2020, me një gjatësi 550 m, me një buxhet prej 39,600.00€, do të thotë se do të asfaltohet, pastaj për këtë fshat kemi planifikuar edhe një shumë buxhetore prej 60,000.00€.

Fazat tjera i kemi parë që janë komplet projekte nëpër fshatra, madje edhe më parë kam kërkuar nga ju që të dalim nëpër fshatra dhe të bashkëbisedojmë me banorë dhe do të shihni se asnjë kërkesë më e madhe se rregullimi i rrugëve nuk do të ketë, e që mbi 98% kërkojnë rrugë, madje me këshilltarin z.Fitim Haziri kemi dal bashkërisht dhe kemi vizituar një rrugë e cila ka rreth 1.7 km gjatësi, në fshatin Dyz, por që ende nuk mund ta fusim në sistem për shkak se nuk kemi mjetet buxhetore, përndryshe sot do ta përfshija në planifikime për vitin 2020.

Sa i përket çështjes që disa prej këshilltarëve po potencojnë se po asfaltohen rrugë në baza politike, është e paqëndrueshme të thuhet ashtu sepse në një lagje nuk ka mundësi të jenë të gjithë LDK sepse në të kundërtën do të dilnim me rezultate zgjedhore mbi 90%.

Sa i përket projektit për ndërtimin e Bulevardit, për të cilin u tha se është bartur disa herë nga viti në vit, ju informoj se është shpall tenderi dhe që 4 muaj jemi duke u ballafaquar me ankesa dhe kërkesa të shumta në Komunë, në Organin Shqyrtues të Prokurimit – OSHP, komisione e ku ta dijë unë, dhe tani jemi në fazën përfundimtare, kemi buxhetin prej 860,000.00€ dhe nuk qëndron ajo që u tha se janë bartur mjetet financiare, por projekti është dy vjeçar 2019-2020, dhe i cili shumë shpejt do të filloj me punime.

z.Fitim Haziri, theksoi, dua të ndërlihem me të gjithë parafolësit që nga z.Mirasad Kamerolli Drejtor i DPZHE, se sa është e interesuar Komuna për zhvillimin ekonomik veç ta shikojmë sa është ndarë buxheti për këtë Drejtori dhe e dim se sa është prioritet zhvillimi ekonomik i Komunës, kurse tek subvencionet e Drejtorit z.Faik Muçiqi, mund të themi se shumica e propozimeve që ishin të LVV-së me një buxhet prej 1,700,000.00€ ishin që të ndahen në infrastrukturë shkollore, laboratore, shëndetësi, ekonomi dhe vetëm 500,000.00€ ishin për subvencionime të bizneseve. Sa i përket bulvardit, arsyeja e ankesave është se pikërisht ju vet e keni bërë punën që të bëhen ankesa kur dihet që Kryetari i Komunës e ka planifikuar tenderin ti jepet një shoku të tij dhe për këtë ofertuesit tjerë kanë bërë ankesë ngase përfituesi ka qenë për 200,000.00€ më i shtrenjtë se sa të tjerët, i kam nxjerrë të gjitha dokumentet. Sa i përket asfaltit, përderisa shkoni dhe jua shtroni vllaznillakut t'juaj deri tek dera e tyre është absurde ti lëni ato

fshatra që sa vite bëjnë kërkesa, andaj më mirë do të ishte t'ju asfaltoni atyre rrugët se sa rrugët e vllaznillakut t'juaj.

z.Mirsad Kamerolli, Drejtor i DPZHE, i drejtohet parafolësit, theksoi, buxheti është ky që është, për që nuk dim të zhvillojmë projekte, gjithë buxhetin do ta destinoja në zhvillim ekonomik, mirëpo këto janë mundësitë. Ju përmendët gjitha fushat dhe në një formë u pajtuat që në të gjitha fushat ka nevojë për investime, qoftë në shërbime publike, shëndetësi, arsim.

Sa i përket asaj që e cekët (se keni mos dije për implementim të projekteve të cilat rrisin zhvillimin ekonomik), ju garantoj se nuk mund ta gjeni një tjetër që din më shumë.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i DPUMM, theksoi, sqarim rreth bulevardit, kushdo që është i interesuar mund t'i shoh dokumentacionet, kurse ti (i drejtohet këshilltarit Fitim Hazirit) nuk keni nxjerrë asgjë dhe nuk keni kurrfarë informatash rreth këtij procesi por vetëm fol ashtu sepse ende është në fazat e tenderimit. Personi i 6-të me radhë i vlerësuar sipas ofertës, është person politik i cili ka dashtë dhe vazhdon të bëjë pengesa. Nga komisioni është shpall ofertuesi i parë që është më i lirë me çmim dhe që përmbush dokumentacionin përkatës, pastaj është bërë ankesë e cila ka kaluar fazat si në shkallë të parë si në shkallë të dytë që është OSHP, detyrë kjo e cila është e Zyrës së prokurimit, por ja që më duhet të jap sqarime sepse projekti është i DPUMM.

Pasi kemi menduar që kjo çështje është mbyll dhe që oferta e dytë sipas radhës së vlerësimit nga komisioni do të shpallet fituese e tenderit, mandej nëse as ky nuk plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret me dokumentacion, vie në shprehje oferta e tretë më e lirë, e kështu me radhë ngase këto çështje janë të rregulluara me procedura ku tek në fund vie në shprehje ai i 6-ti. Pra këto janë rregulla të prokurimit jo tonat si Komunë, dhe tani jemi në fazën e rivlerësimit të të gjithë dokumentacionit sipas ofertave deri në përzgjedhjen e një operatori i cili do të kryej këto punime, andaj nuk qëndron ajo që u tha kinse i kanë thënë filanit e gjëra të ngjashme, por janë rregulla ligjore që duhet të përfillen.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, unë e hedh në votim këtë propozim buxhet sipas materialit përkatës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 20 vota për, 9 vota kundër dhe 5 vota të përmbajtura, u miratua propozim vendimi për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2020 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2021 – 2022, sipas materialit të dërguar për shqyrtim në këtë mbledhje.

3. Propozim vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës – SHSKUK.

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë – DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, para vetës keni propozim vendimin e Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë SHSKUK-së, propozim të cilit paraprakisht i ka paraprirë një kërkesë e SHSKUK-së e datës 30.08.2019 të cilës iu kemi përgjigje dhe kemi ndarë njësinë kadastrale parcelë 260 në Zonën kadastrale Podujevës në kuadër të QKMF-së, parcelë kjo prej 5637m n'kuadër të të cilës është i ndërtuar objekti i spitalit të ri dhe objekti 2 në afërsi të tij i cili do të rrënohet. Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të Komunës, e cekur më lartë bëhet me qëllim të ndërtimit të objektit aneks dhe në këtë mënyrë do të funksionalizohet Spitalit i Përgjithshëm i Podujevës sipas vendimit të vitit 2016.

Pra kjo ishte në pika të shkurtra dhe kërkohet nga Kuvendi që ta përkrahë këtë propozim vendim me qëllim të ndërtimit dhe funksionalizimit të Spitalit të Përgjithshëm të Podujevës si Komunë më e madhja me territor në Republikën e Kosovës dhe e treta numër të popullsisë.

z.Afrim Shabani, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e LDK-së, e mbështesim këtë propozim vendim sepse është një hap i një rëndësie të veçantë për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore sekondare për qytetarët tanë që kanë nevojë për shërbime të tilla e që në këtë bëjmë pjesë të gjithë.

Sa për rikujtim, më 29 qershor 2016 është marrë Vendimi po nga Kuvendi i Komunës së Podujevës, për organizimin e kujdesit shëndetësor sekondar në Komunën e Podujevës – spital i përgjithshëm në Komunën e Podujevës, ku më pas më 27 tetor 2016 nga Ministria e Shëndetësisë është marrë Vendimi për themelimin e Spitalit të Përgjithshëm të Podujevës.

Si këshilltar të Kuvendit por edhe si qytetar i Komunës së Podujevës, dëshiroj t'ju rikujtoj se një institucion i tillë është i domosdoshëm për shumë arsye, ndër të tjera, Komuna e Podujevës ka një territor jashtëzakonisht të madh që hyn në rendin e Komunave të mëdha të Kosovës dhe po ashtu me numër të madh të banorëve e që i plotëson kushtet të ketë një Spital të tillë. Deri tani qytetarët tanë kanë marrë vetëm shërbime primare shëndetësore, kurse shërbimet sekondare i kanë marrë në QKUK në Prishtinë ku me këtë rast ka pas edhe ngarkesa të ndryshme për shkak se nga gjithë territori i Kosovës kërkojnë shërbime të tilla në QKUK andaj qytetarët tanë kanë pasë edhe vështirësi të ndryshme në marrjen e atyre shërbimeve sekondare të ndryshme.

Me ndërtimin e objektit aneks dhe funksionalizimin e Spitalit të Përgjithshëm të Podujevës do të ketë shumë efekte pozitive për marrjen e shërbimeve sekondare shëndetësore si dhe diagnostifikimin e hershëm të sëmundjeve të ndryshme, po ashtu një formë do të ndikoj edhe në kursimin e gjepave të qytetarëve sepse shumë shpenzime do të reduktohen.

Për domosdoshmërinë e këtij vendimi dhe kontributin për funksionalizimin e Spitalit duhet t'i jemi mirënjohës në veçanti Kryetarit të Komunës z.Agim Veliu dhe Kuvendit të Komunës i cili pati marrë Vendim për Organizimin e kujdesit dytësor shëndetësor në Komunën e Podujevës. Duke iu gëzuar faktit për ndërtimin këtij aneks objekti dhe funksionalizimit të Spitalit të Përgjithshëm të Podujevës, unë si profesionist shëndetësor dhe qytetarë i kësaj treve uroj që spitali të disponoj aparaturën më të përsosur të kohës por gjithashtu uroj të ketë sa më pak pacient.

z.Vendenis Lahu, theksoi, siç duket po vie dita me ja pre shiritin spitalit për herë të tretë, dikush do të thoshte ndoshta shiritat janë për tu prerë, pajtohem. Spitali i Përgjithshëm është lehtësim i madh për qytetarët por puna e themelimit, ndërtimit, funksionalizimit të tij është zvarritur tej mase gjë që janë shkaktuar dëme materiale që qytetarët e Komunave të tjera nuk i kanë pasur dhe nuk janë përballuar sepse veç i kanë spitalet e tyre të përgjithshme. Mungesa e spitalit tek ne para së gjithash vie nga mungesa e politikave shëndetësore nga qeverisja lokale, nuk ka pasur kurrfarë politikash kadrovike as në të kaluarën as tani, kuadrot më të mira po ikin jashtë vendit, kurse qeverisja lokale nuk bënë asgjë dhe është e pa interesuar. Qendra emergjente nuk ka specialist të mjekësisë urgjente, nuk kemi anesteziolog, nuk kemi kirurg, nuk kemi as ortoped reumatolog, kjo është për keqardhje, e që Komuna jonë nuk ka bërë bash asgjë për këtë punë, një Komunë me 90000 banorë të mos ketë nivel dytësorë shëndetësorë, kjo ndodh vetëm në Komunën tonë, në asnjë Komunë tjetër, madje me 60000 banorë e kemi Vushtrrinë, Mitrovicën e Jugut por edhe të Veriut. Me rastin e shtimit të aneksit të spitalit që veç është i ndërtuar do të prishet objekti në të cilin është i vendosur rëntgeni dhe mamografi, andaj mendoj se është shumë e rëndësishme të dimë se ku do të vendosen këto 2 aparatura.

z.Fatmir Rudari, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së, e përkrahim këtë propozim vendim të cilin e konsiderojmë edhe projekt mjaft të rëndësishëm për Komunën e Podujevës dhe që duhet t'i gëzohemi të gjithë.

z.Zaim Thaqi, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale - DSHMS, theksoi, sot para vetës kemi një pikë e cila është e lidhur me shëndetësinë, në fakt me shëndetin e qytetarëve të Komunës së Podujevës e që unë mendoj se absolutisht është një ditë e madhe për qytetarët e Komunës së Podujevës, dhe shfrytëzoj rastin të falënderoj të gjithë kontribuuesit e deritanishëm që kemi ardhur deri te një vendim i tillë pozitiv, duke përfshirë edhe këshilltarët e Kuvendit të cilët me sugjerimet e tyre dhe analizat që i kanë bërë kësaj çështje kanë vlerësuar pozitivisht këtë propozim vendim e që në fakt kemi të bëjmë me një pikë që ka të bëjë me dhënien në shfrytëzim afatgjatë një pronë të paluajtshme, të përcaktuar mjaft mirë dhe e kërkuar me ngulm nga SHSKUK, do të thotë ka qenë kërkesë e tyre e përcaktuar dhe e vlerësuar mjaft mirë edhe nga ekspertët e tyre. Mendoj që për këtë pikë, pa u lëshuar në çështje të cilat sa pash ishin paksa subjektivizëm kur është fjala për përzgjedhjen e profesionistëve shëndetësorë e kështu me radhë, unë dëshiroj t'ju sqaroj se me këtë vendim që sigurisht do të miratohet sot, SHSKUK një prej prioriteteve të tyre do të mbetet edhe përgatitja e kuadrove që do të punojnë në Spitalin e Përgjithshëm të Podujevës, do të thotë që kjo është një nismë e mirë për të gjithë qytetarët por edhe sa i përket planifikimeve të profesionistëve shëndetësorë duke marrë parasysh se në nivelin parësor shëndetësorë jemi të kursyer prej shërbimeve që neve na nevojiten siç janë, anesteziologët, ortopedët, reumatologët dhe doktor specialistët e mjekësisë emergjente, ngase sipas Ligjit për shëndetësi, në nivelin parësor shëndetësorë parashihen mjekët familjar dhe disa konsultant ekskluzivisht pediatër, gjinekolog dhe stomatolog, kurse profesionet tjera do të organizohen dhe mbeten objektiv dhe prioritet i SHSKUK-së. Unë dëshiroj t'ju tregoj një informatë e cila mund të cilësohet edhe si lajmë i mirë për ata që dëshirojnë të dëgjojnë një gjë të tillë, se menaxhmenti i SHSKUK veç ka filluar planifikimet se çfarë profesionistësh do të ketë në Spitalin e Përgjithshëm të Podujevës dhe çfarë do të planifikohet për të ardhmen, e që dua të them se ditë të mira po vijnë për profesionistët tanë dhe për qytetarët e Komunës së Podujevës sepse këtu do të marrin shërbimet e nivelit më të avancuar shëndetësor.

z.Bajram Ajeti, theksoi, se vendimi në fjalë është i vitit 2016 do të thotë janë në pyetje mbi 3 vite vonesa dhe mendoj se kjo është një propozim vendim i përgatitur për fushat sepse ju nuk mund ta realizoni këtë dhe tani përpiqeni të arsyetoni se do të bëhet në pjesën ku aktualisht është QKMF e që unë besoj se kësaj i duhet të rritet me ofrim të shërbimeve primare ndaj qytetarëve dhe aty të vejmë edhe emrin spital që do të ofroj shërbime shëndetësore të nivelit sekondar, mua më duket se kjo është një lojë dhe diçka jo serioze, por sigurisht që ju keni qëllime për fushat dhe nuk ju shohë për të madhe ngase jeni në dijeni shumë mirë se ka pasur lojëra me objektin e maternitetit duke thënë se e bëmë spital, jo e bëmë, jo u pre shiriti, jo erdhi Kryeministri e vizitoj, pastaj sa pajisjet e që ndoshta me qindra mijëra euro i keni marrë aty e që besoj se tani atyre veç iu ka kaluar afati të cilat kanë qenë ndihmë nga Banka Botërore të cilat janë sjellë përmes një llapjani z.Nexhip Sheholli. Kështu që ne kundër spitalit nuk dalim, bëjeni spitalin tamam sikur në Komunat tjera që janë, por të ndërtohet spital në oborr të QKMF-së dhe t'i jepet madje edhe epiteti aneks, kjo është qesharake, thua që Komuna nuk ka territor dhe nuk ka prona publike ku mund të ndërtohet një spital për shërbime shëndetësore të nivelit sekondar i cili do të plotësonte kushtet tamam, e jo për fushatën, jo për 4 vite, por do të plotësonte ndoshta për një kohë shumë të gjatë 20-30 vite ku vërtetë do të ofroheshin shërbime shëndetësore përkatëse, ndërsa të ndërtohet spital në afërsi të qendrës së qytetit, mendoj se qoftë kërkesat apo edhe vendimet e juaja dhe kushdo që i ka marrë janë të gabuara.

Pra edhe njëherë e përsëris sepse edhe ashtu e kam bindjen, do shihemi sërish, do bisedojmë sërish, ngase i konsideroj vetëm disa planifikime të cilat i keni në imagjinatën tuaj, por t'i realizoni nuk mundeni sepse ta shndërroni spitalin në një aneks të QKMF-së, mendoj se më këtë mund të qeshin edhe fëmijët e jo që mund ta shohim si diçka që mund ta realizoni, ngase në të kaluarën nuk keni realizuar dhe se maternitetit e keni bërë spital, vetëm për vota, pastaj sërish për vota në mandatin e dytë, dhe tani bëni spitalin tjetër me aneks, vetëm për vota, andaj mendoj se është një lojë me qytetarët dhe diçka që po bëhet shaka me qytetarët, shërbimet shëndetësore nuk janë shaka.

z.Zaim Thaqi, Drejtor i DSHMS, theksoi, pa dashur t'i jap konotacion politik kësaj pike të rendit të ditës dëshiroj edhe njëherë të përsërisë se edhe paraprakisht dua të fokusohem më shumë rreth përfitimeve të qytetarëve sa i përket një vendimi të tillë. Ne sot nuk kemi të bëjmë rreth sistemit shëndetësorë, a është gabim apo është mirë, por kemi të bëjmë me një pikë të rendit të ditës e cila ka të bëjë me dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronën e paluajtshme SHSKUK-së, kjo është ajo që shqyrtohet dhe që po kërkohet, andaj edhe vlerësoj se është moment i mirë ky për Komunën e Podujevës dhe qytetarët tanë. Subjekti që parafolësi e përfaqësoj nëse dëshironi votojeni, por ashtu siç i pash në fillim nga të tjerët ky propozim është vlerësuar mjaft mirë dhe konsideroj se do të votohet, ndërsa rreth çështjes së organizimit ndoshta mund të diskutojmë ndonjëherë tjetër, por sot, e përsërisë, që kemi të bëjmë me shqyrtimin e propozimit për dhënie të pronës së paluajtshme në shfrytëzim, duke përfshirë edhe kërkesën e SHSKUK-së sipas të cilës edhe është propozuar kjo pikë e të cilën besoj se keni pas mundësi ta lexoni.

z.Bajram Ajeti, theksoi, lidhur me këtë nuk po përfshihet vetëm prona por e cekët edhe ju vet Drejtor që (do të shkatërrohet kjo dhe do të ndërtohet kjo) andaj a është kjo njësoj apo jo.

Shërbimet tjera siç janë rentegeni etj, a nuk ju duhen qytetarëve a, prandaj lëreni mos boni shaka.

z.Zaim Thaqi, Drejtor i DSHMS, theksoi, këshilltarja znj.Adelinë Stublla, në mbledhjen e KPF-së më pyeti se çfarë do të bëhet me shërbimin e radiologjisë, dhe unë e dhashë një përgjigje, ne kemi një kompani të kontraktuar që do t'i zhvendosë ato aparatura. Pastaj ndoshta ja vlen të cekem edhe detajet, nga viti 2016, e këndej janë nga 200,000.00€ buxhet që ndahen nga Ministria e Shëndetësisë për Spitalin e Përgjithshëm të Podujevës por që të njëjtat shpenzohen për qëllime të SHSKUK-së ngase nuk është në kompetencën tonë kjo çështje, dhe tani në këtë vit që jemi ato mjetet do të destinohen vetëm për hartimin e projektit zbatues për ndërtimin e objektit në fjalë të Spitalit të Përgjithshëm të Podujevës, mandej ne qysh herët kemi planifikuar se ku t'i vendosim pajisjet që janë të radiologjisë, pastaj kemi marrë garnacë që punimet për ndërtimin e objektit aneks të Spitalit të përgjithshëm të Podujevës do të fillojnë qysh në pranverë të vitit 2020, kurse deri atëherë neve na mbetet që ambientet e spitalit të tanishëm që dikur është quajtur maternitet, do t'i shfrytëzojmë sepse është hapësirë e destinuar për shërbimin e radiologjisë, objekt në të cilin do të zhvendosen komplet aparatura e radiologjisë, rentegeni, mamografi digjital, pastaj edhe shërbimin tjetër dhe aparatura tjera që kryhen nga radiologu do të kryhen në atë objekt. Pra është kompania e kontraktuar për zhvendosje dhe unë i garantoj qytetarët se nuk do të mbetet asnjë ditë pa shërbim shëndetësorë.

z.Bajram Ajeti, theksoi, kam përvojë në Ministrinë e Shëndetësisë për rreth 5 vite, andaj edhe po diskutoj, një gjë të cilën e potencoj Drejtori parafolës z.Zaim Thaqi ishte se, planifikojmë që do të krijojmë edhe stafin apo personelin profesional për të qenë në shërbim të qytetarëve në shërbimet shëndetësore, mirëpo për të krijuar një staf të tillë a jeni në dijeni se vite duhen, ndoshta 10 vite, andaj objektin mund ta ndërtoni por nëse nuk keni planifikuar deri tani dhe nuk keni bërë asgjë deri tani për sigurimin e stafit shëndetësorë dhe atë specialistik, unë mendoj se do

ta bëni një objekt aneks në atë hapësirë, do të bëhet një tender i mirë etj, por përndryshe me këtë logjikë, me këtë planifikim apo pa planifikim të fillohet spitali, kjo është qesharake.

z.Afrim Shabani, theksoi, sqarim parafolësit, ju keni punuar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe sigurisht jeni në dijeni shumë mirë që për të marrë një specializim të një specifike që i takon nivelit sekondar duhet të keni spitalin e përgjithshëm në komunën prej nga vie, këtë e ndërlidhi me vetën sepse kurrë nuk kam mund të marrë një specializim ashtu siç e kanë marrë kolegët nga komunat tjera që kanë spital të përgjithshëm. Pra kjo ka qenë dhe është problematikë për kuadrin e ri që do të vie të punoj në Spitalin e Podujevës, pastaj ne kemi 2 specialistë ortoped të cilët punojnë në Mitrovicë të cilët mund të vijnë në Podujevë të punojnë ashtu siç munden edhe specialistë të tjerë nga komunat tjera të vijnë në Podujevë të punojnë. Prandaj ne kemi të bëjmë me këtë çështje e që konsideroj se është një hap shumë i mirë që kemi ndërmarrë për të ndërtuar dhe funksionalizuar Spitalin e Përgjithshëm të Podujevës, kurse me kohë do të kemi edhe kuadro të mjaftueshëm.

z.Vendenis Lahu, theksoi, Drejtori i DSHMS e tha që mamografi dhe rentegeni do të zhvendosen në objektin ku është materniteti, por besoj që ju jeni në dijeni se çfarë rrezatimi krijojnë këto aparatura, dua të them se ai objekt duhet të ketë një izolim (dyert me plumb, muret etj) prandaj pyes a i ka këto specifika objekti i maternitetit, apo do t'i bëni.

z.Hasan Ajeti, theksoi, para vetës kemi një propozim vendim për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë SHSKUK-së, kjo si rezultat i një Memorandumi të arritur mes Drejtorit të SHSKUK-së z.Basri Sejdiu dhe Kryetarit të Komunës së Podujevës z.Agim Veliu. Sa i përket përgjegjësi që ndërlidhen me investime, rekrutime etj, unë jam shumë i sigurt që këshilltari z.Bajram Ajeti e dinë shumë mirë që kjo është përgjegjësi e SHSKUK-së përkatësisht niveli dytësorë nuk është në kompetencë të nivelit lokal, ndërsa sa i përket temave tjera kjo mbetet të shihet në vazhdim. Pra ky propozim është sjellë në bazë të kërkesës së SHSKUK-së dhe Memorandumit ku prona është kërkuar të jepet në shfrytëzim, kurse sa i përket rekrutimeve, stafit etj, krejt këto janë të SHSKUK-së, por jo të Komunës.

z.Vendenis Lahu, theksoi, ne e dimë që institucionet e kujdesit dytësor shëndetësorë janë nën përkujdesjen e Ministrisë së Shëndetësisë, përveç kësaj të drejtën e themelimit të institucioneve shëndetësore kanë edhe komunat, përkatësisht Kuvendet e tyre e që në rastin tonë këtë e kemi bërë në Kuvendin e Komunës së Podujevës në mandatin e kaluar, dhe kjo rregullohet me nenin 20 pika 1 të Ligjit për shëndetësinë në Kosovë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, nganjëherë në pika të ndryshme të rendit të ditës po kalojmë në debate jo profesioniste, për të mos i quajtur banale. Nuk kemi nevojë ta politizojmë këtë çështje me gjëra të kota por kemi të bëjmë me deklaram – votim, a jemi që SHSKUK-së (në bazë të kërkesës së tyre) t'i jepet në shfrytëzim prona e paluajtshme, konkretisht a jemi që të ndërtohet objekti aneks dhe të funksionalizohet Spitali i Përgjithshëm në Podujevë, apo jo, e që ne jemi për, ndërsa për format e rekrutimit të stafit, blindimit të aparateve etj, duhet të kryejnë punën e vet secili prej organeve qoftë nivel lokal qoftë qendrorë. Prandaj ne është mirë ta miratojmë këtë propozim vendim, në mënyrë që të mos dalim jo mirë pastaj për shkak të refuzimit eventual dhe të mbetemi pa Spital, nëse ka element që të votojmë kundër, thuajeni dhe do ta votojmë kundër, mirëpo nuk është mirë të futemi në tema të ndryshme siç ishte rasti se ku do ta marrim një ortoped, shembull. Pastaj jemi në dijeni se të gjithë specialistët dhe punëtorët tjerë të fushave tjera të shëndetësisë janë duke ikur në Komuna tjera, andaj duhet të shikojmë se si mund t'i ndalim këta dhe t'ju krijojmë kushte dhe vende që të punojnë në Podujevë. Spitali i Përgjithshëm në Podujevë duhet të funksionalizohet gjithsesi, prandaj ta miratojmë këtë propozim sipas kërkesës së SHSKUK-së e pastaj ne mund të diskutojmë dhe madje edhe të dalim shumë shpesh

në atë lokacion dhe të shikojmë se çfarë është duke ndodhur. Unë jam në dijeni se Kryetari i Komunës e ka prerë shiritin në zgjedhjet e kaluara në vitin 2017, por tani kemi çështje tjetër e që neve na mbetet në kompetencë të shikojmë se a janë përfillur procedurat dhe a është përfillur ai projekt, andaj edhe kemi kërkesën e SHSKUK-së për një gjë të tillë, prandaj i nderuar Kryesues tema është e qartë, kemi të bëjmë me ndërtimin e një objekti të ri me qëllim të funksionalizimit të Spitalit të Përgjithshëm në Podujevë, dhe mos të banalizohet debati për këtë çështje por vëre në votim.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, konsideroj se gjërat janë të qarta rreth kësaj teme dhe se u diskutua mjaft, andaj meqë nuk të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim, këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës dhe konstatimeve të rekomanduara nga KPF.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 21 vota për, asnjë votë kundër dhe 6 vota të përmbajtura, u miratua propozim vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës – SHSKUK, sipas materialit përkatës të dërguar për shqyrtim në këtë mbledhje dhe konstatimeve nga mbledhja e KPF-së e mbajtur më 20.09.2019

4. Propozim vendimi për dhënien e Pronave të paluajtshme në shfrytëzim afatshkurtër Kompanisë Kosovare për Distributum dhe Furnizim me Energji Elektrike - KEDS

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse ndër të tjera theksoi, para vetës kemi propozim vendimin për dhënien e pjesëve të pronave në shfrytëzim afatshkurtër KEDS-it.

Siç jeni në dijeni gjatë këtij viti në disa raste kemi ndarë pjesë të pronave dhe ju kemi dhënë prona të tilla kësaj Kompanie dhe rezultati vërehet në terren ngase KEDS ka investuar dhe vazhdon të investoj në zgjerimin dhe përforcimin e rrjetit të energjisë elektrike në territorin e Komunës së Podujevës, prandaj edhe tani kemi dy kërkesa për dhënie të dy pjesëve të pronave në shfrytëzim e që mendoj se do të jenë të fundit sipas bisedimeve me përfaqësues të KEDS-it, ngase po përmbillet kjo çështje, njëra ka të bëjë me një pjesë të parcelës prej 30m² në rr.”Xhemajl Mustafa” në afërsi të fabrikës së armaturës, ish pompa e vjetër e derivateve, si dhe kemi pjesën tjetër të parcelës në rr.”Ali Ajeti” tek trekëndëshi i ashtuquajtur “qeshmja e Azemit” në të cilën do të ndërtohet një trafo rezervë për qytetin e Podujevës. Prandaj nga Kuvendi kërkohet miratimi i këtij propozim vendimi për dhënien e pjesëve të pronave sipas materialit përkatës, për një periudhë prej 15 viteve, pa pagesë konform Ligjit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, për raste të veçanta.

z.Bajram Ajeti, theksoi, lidhur me këtë pikë nuk është diçka e re sepse ka vazhdueshëm propozime të tilla, mirëpo unë po foli në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së. Ne kemi pas mospajtime edhe për trajtimin jo të barabartë të qytetarëve dhe diskriminimin e qytetarëve rreth njehsorëve elektrik, për sot themi kështu, për deri sa KEDS është kompani private e cila dihet se si dhe nga kush ka ardh në Kosovë, ne mendojmë që deri sa nuk i vëhet kusht, të paktën nëse i japim pronë në shfrytëzim përse të mos jetë ndriçimi i rregulluar në atë lagje nga ana e po asaj Kompanie, pra diçka ta kompensoj atë lagje apo rrugë, e jo t’i jepen prona në këtë mënyrë, andaj edhe ne do të abstenojmë.

z.Bashkim Sylja, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së, e përkrahim këtë propozim vendim.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka këshilltarë tjerë të lajmëruar për të marrë fjalën, e vë në votim këtë propozim vendim sipas materialit përkatës të dërguar.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 20 vota për, asnjë votë kundër dhe 5 vota të përmbajtura, u miratua propozim vendimi për dhënien e Pronave të paluajtshme në shfrytëzim afatshkurtër Kompanisë Kosovare për Distribuid dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS, sipas materialit përkatës të dërguar për shqyrtim në këtë mbledhje.

5. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në fshatin Lupç i Poshtëm

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse ndër të tjera theksoi, edhe për këtë pikë të rendit të ditës kemi të bëjmë me dhënien në shfrytëzim afatshkurtër pronën e paluajtshme të Komunës, në zonën kadastrale Lupç i Poshtëm vendi i quajtur Bugurdoll, parcela 495-0 nga e cila janë ndarë dy parcela dhe nga Kuvendi janë dhënë në shfrytëzim ku në njërin është ndërtuar një mini fabrikë e peletit dhe në tjetrën do të ndërtohet një objekt montazh për përpunimin e mobileve, ndërsa ka mbet edhe kjo pjesë e kësaj parcele e cila nëse miratohet sot do të zhvillohen procedurat përkatëse për dhënie e të njëjtës në shfrytëzim përmes ankandit publik, pronë e cila thuajse pjesa kryesore është e mbuluar me mbeturina por që kemi paraparë të jepet në shfrytëzim për qëllime bujqësore e që mendojmë se do të krijoj edhe vende të reja të punës por edhe të ardhura për Komunën, andaj edhe kërkohet miratimi i të njëjtit.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, besoj se jemi për që pronat publike të jepen në shfrytëzim, por unë lidhur me këtë pronë edhe në mbledhjen e KPF-së jam ndalur paksa dhe kam diskutuar më gjatë. Neni 5 i këtij propozim vendimi e rregullon kështu, dhe ashtu duhet të jetë, *të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës të dhënë shfrytëzim do të rregullohen me kontratë të veçantë të nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe përfituesi, pas përfundimit të procedurave ligjore*, ndërsa në nenin 6 thuhet, *pas miratimit të këtij propozim vendimi, për zbatimin kujdesen Komisioni vlerësues për dhënien e pronave të paluajtshme të komunës në shfrytëzim, dhe Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë*. Ne kemi shumë kontrata të lidhura dhe as në mandatin e kaluar por as në këtë mandat nuk na është sjellë asnjë raport lidhur me këtë çështje, edhe përkundër kërkesave tona zyrtare dhe publike që të sjellët një raport për pronat publike në qytet, gjendjen e qirave, gjendjen e atyre që kanë borxhe për pronat e shfrytëzuara në territorin e Komunës së Podujevës, andaj sot sërish zyrtarisht po kërkoj nga Komisioni - kryesuesi i Komisionit vlerësues pjesë e të cilit janë edhe përfaqësues të grupeve të këshilltarëve nga radhët e subjekteve të ndryshme politike, por kërkoj edhe nga Drejtori i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë. Jam i sigurt se sot nuk ka përgjigje askush, mirëpo në seancën e radhës, ta përgatitin një raport për të gjitha pronat e dhëna me qira, shumë e inkasimit, shumë e borxheve, uzurpimet e pronave publike dhe çështje tjera.

Tani lidhur me këtë pronë sipas këtij propozim vendimi, nuk jam në dijeni se a ka ndonjë kërkesë nga ndonjë qytetarë, unë edhe në KPF e kam thënë që nëse ka kërkesë dhe nëse Drejtori i DPKGJ e dinë se kush do të jetë përfitues i asaj prone e jo ndokush tjetër, është mirë ta dimë edhe ne, madje do ta ndihmojmë dhe të ecë përpara me zhvillim, por duhet ta dimë pse po ja japim dhe si po ja japim, me çfarë çmimi edhe pse komisioni e rregullon këtë çështje, mirëpo ky Komision nuk është mbledh asnjëherë dhe madje ka probleme në këtë aspekt dhe këtë e dinë shumë mirë anëtarët dhe kryetari i komisionit që këtë komision nuk e ka në rregull sepse disa

herë janë lëshuar mbledhjet ngase nuk u janë dhënë llogari anëtarëve të komisionit për çështje të ndryshme që kanë kërkuar, madje në një gjendje të tillë është edhe komisioni i ankesave për dhënien e pronave në shfrytëzim, komisione këto që janë themeluar nga ky Kuvend dhe ne si Kuvend nuk jemi në dijeni për shumën e borxheve që kanë njerëz të ndryshëm këtu të cilët marrin prona në shfrytëzim dhe nuk paguajnë qira qe 8 vite, prandaj të paktën unë dëshiroj të dijë kush janë ata persona, si dhe t'ju japim pronat atyre që paguajnë qiranë në mënyrë që të shmangim një situatë sikurse që ka qenë ish Hotel Llapi me 1200 m² i cili është dhënë në shfrytëzim nga komisioni vlerësues me çmimin më të lirë prej 180€ nipit të ish përfituesit paraprak, çështje e cila ka ndodhur në mandatin e juaj z.Abaz Llugaliu, dhe tani dëshirojmë të dimë a i ka kryer borxhet ky person, pastaj a janë shlyer borxhet ndaj Komunës nga përfituesi i lokalit, ish banka në qendër të qytetit, dhe i cili është demoluar pa lejen tuaj, mandej a keni prona të uzurpuara në qytet dhe kush janë ata persona që deri tani në vitin 2020 që po hymë uzurpojnë prona publike dhe nuk paguan qira. Pastaj dëshirojmë të dimë edhe çmimin fillestar për prona të cilat do të jepen në shfrytëzim.

Prandaj, i nderuar Drejtor i DPKGJ z.Abaz Llugaliu, në seancën e radhës kërkojmë listën e pronave komunale, të cilën e kërkoj qe 8 vite, pastaj listën e pronave publike në qytet, listën e pronave të dhëna në shfrytëzim, listën e uzurpimeve, sepse dëshiroj të dijë se kush janë ata që mbajnë pronë publike të uzurpuar midis qytetit dhe çështje tjera të ngjashme që i ceka, sa për njoftim ne Komisioni i Komunal i Aksionarëve të Ndërmarrje Publike Stacioni i Autobusëve kemi vizituar hapësirat e Stacionit të Autobusëve ngase jemi duke punuar për konsolidimin e bordit dhe çështje tjera të kësaj ndërmarrje, dhe vetë përgjegjësi i asaj ndërmarrjeje tregon se si janë ndërtuar mure në pronë të stacionit dhe janë ndërtuar shtëpi në atë pronë e cila është midis qytetit të Podujevës, pastaj ka persona që paguajnë qira personave tjerë për prona publike, e që mund të them se deri në vitin 2005 – 2006 ka qenë kohë e emergjencës pas lufte, por jo edhe tani kur jemi në vitin 2019. Pra këto janë disa prej çështjeve që duhet të rregullohen, nuk është fjala për pronën sipas këtij propozim vendimi sepse ajo duhet të jepet në shfrytëzim ngase pak vlerë ka ajo pronë atje.

Edhe njëherë i nderuar Drejtor, në mënyrë shumë kolegiale po ju drejtohem, deri sa të marrë ato lista që i kërkoja, nëse nuk e sjellë deri në seancën e ardhshme, unë personalisht do të rri nga 8:00 deri në ora 16:00 kur ta kryesh orarin, te dera e zyrës ku punon ti, deri sa të më plotësohet kërkesa, andaj ky është paralajmërim dhe kërkesë zyrtare ngase të kam shkruar përmes e-mailit zyrtar por që më ke dërguar vetëm listën e pronave në fshatra e që mua nuk më intereson shumë për prona në fshatra të thella si Metergoc etj, prandaj është mirë të sjellësh listat që kërkoja në mënyrë që të mos bëhemi aq banal që unë të vijë të rri para zyrës tënde me gjithë gazetar e media tërë ditën deri sa të sjellësh listat që kërkoja, përndryshe tregoma cila është arsyeja që ju nuk më ofroni listën e pronave komunale, listën e pronave publike të dhëna me qira, listën e borxheve të qirasë dhe listën e pronave publike të uzurpuara. Nëse ke presion prej ndonjë njeriu apo ndonjë kërcënim, vetëm trego dhe mund të vizitojmë bashkërisht atë pronë, ose të paktën privatisht tregoj ndokujt prej këtij Kuvendi. Unë ju kuptoj juve Drejtor, por nuk po dëshiroj ta kuptoj asnjërin prej atyre shfrytëzuesve të atyre pronave, dhe këtu ju them se ato prona do të lirohen besoni, ngase nuk do të shkon kështu që dikush të mban prona publike në qytet dhe të mos paguajnë asnjë cent qira Komunës, kush janë ata persona, nëse nuk mundesh ti, shumë lehtë është, jepni dorëheqje dhe përfundon kjo, apo publikoj në televizione të gjithë uzurpatorët dhe ata borxhlinj, pa dallime, politikan, luftëtar etj, sepse ka pas shumë etiketime në këtë aspekt ku një ndër ata kam qenë edhe unë personalisht me lloj lloj marifetesh politike jemi etiketuar ne luftëtarët. Edhe njëherë po e përsërisë kërkesën time, 1 muaj keni kohë deri në seancën e radhës

të sjellni ato lista që i kërkoja, sepse shumë lehtë mund të sigurohen ato lista vetëm ta angazhoni ndonjë zyrtar nga stafi juaj, keni të dhëna dhe materiale të mjaftueshme që nga koha e ish sistemit të kaluar.

Problemi tjetër që dua të cek lidhet me Komisionin vlerësues për dhënien e pronave në shfrytëzim, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së e kemi një anëtar në atë komision i cili ka ngritur shqetësimet rreth punës së këtij Komisioni, e që unë edhe në KPF e kam theksuar, pastaj edhe Grupi i LVV-së ka një anëtar në atë Komision, kërkoj të sjellët raporti i detajuar rreth kësaj prone e cila është propozuar për dhënie në shfrytëzim e që ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së jemi për miratim të këtij propozim vendimi, andaj të jeni të sigurt dhe në dijeni të gjithë anëtarët e Komisionit në fjalë se aq sa do të merrem me Drejtorin e DPKGJ lidhur me listat që ja kërkoja, njëjtë do të merrem edhe me të gjithë anëtarët e këtij Komisioni nëse i njëjti nuk e sjell raportin rreth kësaj prone dhe pronave tjera që i ka dhënë në shfrytëzim.

Nëse Drejtori i DPKGJ ka përgjigje mund ta merr fjalën që tani, qoftë për dy temat që i ceka, pastaj unë tani së fundmi po vërej tendenca të zgjerimit të uzurpimeve të pronave publike edhe në vende rurale me të cilat nuk është duke u marrë askush seriozisht pothuajse.

Pra, Drejtor nuk është reale kjo, madje është më shumë se keq, dhe në seancën e radhës do të tentoj të të mbaj 8 orë vetëm për këtë pikë, nëse nuk i sjell listat që i kërkoja, Nënkrjetari është këtu prezent, dhe do t'i shkruaj edhe Kryetarit të Komunës, dhe qoftë nga vendi, qoftë nga foltorja do të tentoj që asnjë pikë e rendit të ditës të mos zhvillohet pa më dhënë përgjigjen përse nuk janë sjellë listat e cekura, nëse nuk sjellën, kështu që si përfundim, dokumenti i kërkuar duhet të sjellët.

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i DPKGJ, theksoi, do të mundohem t'i jap përgjigje këshilltarit z.Rafet Llapashtica, mirëpo për shkak se aq shumë u zgjerua do të kem të pamundur të jap përgjigje në të gjitha ato që i ceku. Përgjigjen sa i përket borxheve nga dhënia e pronave komunale në shfrytëzim me qira do t'ia dërgoj, kurse sa i përket asaj që tha se keni dhënë lokalin në qytet ish banka, me qira me çmimin më të lirë, sigurisht jeni në dijeni se çmimin e përcakton oferta dhe kërkesa.

z.Rafet Llapashica, nga vendi ndërhyr, thekson, përmes përfaqësuesit të subjektit tim kam qenë kundër që ai lokal t'i jepet familjarit të tij dhe në këtë formë me tendencë, pa u kryer borxhi zero zero ndaj Komunës. Nuk do ta lejoja një situatë tillë asnjëherë dhe në asnjë rrethanë.

z.Abaz Llugaliu, vazhdon, lidhur me atë lokal është ndërprerë kontrata dhe ai person është në procedurë përmbarrimore në Gjykatë sa i përket borxheve të mbetura.

Pra listën e borxheve do ta kesh edhe në e-mail, edhe në seancën e radhës, ndërsa sa i përket uzurpimeve të pronave, uzurpimet janë të njëjtat, madje me Ligjin e ish sistemit KSAK të vitit 1986, i cili ende është në fuqi dhe sipas të cilit në asnjë nen nuk mund të thirresh sa i përket uzurpimeve të objekteve dhe pronave publike të cilat i kemi në kohën e tanishme.

Sa i përket çmimit të përcaktuar për dhënien e pronave në shfrytëzim, unë po ceku vetëm nenin e Ligjit 06/L-092 për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim, neni 15 ku është njoftimi publik, paragrafi 3, thotë, çmimi fillestar duhet të caktohet nga Komuna, pra ky çmim fillestar caktohet nga Drejtoria apo sektori përkatës.

Sa i përket interesimit të personave të ndryshëm për marrje të pronave komunale në shfrytëzim, mund të them se neve na vijnë persona të interesuar për një gjë të tillë, por kjo nuk do të thotë se po ai person do ta merr në shfrytëzim pronën përkatëse ngase ky është vetëm vendim paraprak dhe të gjitha procedurat tjera kryhen nga Komisioni vlerësues ku anëtarët e tij janë nga të gjitha subjektet pothuajse sepse ligji e përcakton ashtu, në bazë të çmimit më të lartë të ofruar.

Pra përgjigjen do ta merrni në e-mail dhe atë brenda jave ngase një kërkesë të tillë e ka bërë edhe auditori i përgjithshëm të cilit gjithsesi i kemi raportuar.

z.Bajram Ajeti, theksoi, vërtetë është e çuditshme kur një këshilltar i Kuvendit, kush do qoftë ai, e thotë që me vite të tëra kërkon diçka dhe një Drejtori e caktuar nuk është në gjendje të nxjerrë regjistrin e pronave publike, të nxjerrë pronat e uzurpuara dhe çështjen e qirave dhe borxheve, e them këtë ngase e konsideroj si punë të lehtë këtë dhe nuk mendoj që keni dhënë ndonjë pronë pa kontratë, andaj dhe janë evidencat dhe shënimet. Gjithashtu besoj që edhe lidhur me këtë propozim vendim që po diskutojmë, mendoj që sigurisht do të zbatohet ligji sepse kemi të bëjmë me dhënien në shfrytëzim të pronave publike, ligj të cilin janë të obliguar ta zbatojnë të gjithë, duke filluar nga baza konkurruese por edhe procedura të ndershme.

Megjithatë edhe unë kërkoj nga Kryesuesi i Kuvendit që të bëjë përpjekje që raporti apo regjistri i pronave të sillet sa më shpejt në Kuvend, nuk ka kurrfarë arsytimi për këtë ashtu siç u vë në diskutim fletorja zyrtare e KSAK-së apo gjëra të tilla, ose nuk keni punuar asgjë dhe nuk jeni në dijeni se ku i keni ose keni futur veshët në të shurdhër dhe i kanë marrë ato prona njerëzit të cilët i keni klientel apo që mendoni se nuk do t'ju japin votat dhe shpresoni t'i ruani ata njerëz, ngase përndryshe kjo është skandaloze. Këtë çështje ose do bëjmë me shkrim, ose ta bëni në bazë të asaj që jeni të obliguar të sjellni Kuvendit të Komunës listën në fjalë.

Çështja tjetër e cila nuk lidhet me këtë pikë por që dua të ceku ka të bëjë me një Draft rregullore e cila ka kaluar të gjitha procedurat e cila ka të bëjë me funksionalizimin dhe organizimin e këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane, për të cilën është mbajtur edhe debati dhe diskutimi publik, përse nuk e sjellni në Kuvend për shqyrtim dhe miratim final, të lutem Kryesues i Kuvendit, kjo është detyrë e juaja, e keni miratuar në KPF, ka kaluar gjitha procedurat, ndërsa sot ju bëheni sikurse nuk dini asgjë dhe emëroni njerëz të cilët janë edhe kryetar partie edhe kryetar fshati, çështje kjo e cila është në kundërshtim me ligjin, prandaj mosni sepse këto janë disa veprime të cilat aq sa janë të dëmshme janë edhe të palogjikshme, kështu që kërkoj nga ju dhe nga KPF që në mbledhjen e radhës të vëhet ai dokument në Kuvend për shqyrtim final dhe miratim.

z.Gëzim Namani, Drejtor i Drejtorisë së Administratës – DA, theksoi, sa i përket draft Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatra dhe lagje urbane të qytetit, jemi duke punuar. Kemi afat ligjor deri në muajin dhjetor të këtij viti sepse është nxjerrë një Udhëzim Administrativ i ri, andaj edhe neve na është dashtë t'i bëjmë përshtatjet e drafti rregullore me këtë Udhëzim. Brenda afatit ligjor besoj se do të nxjerrët ai dokument dhe do vazhdojmë tutje. Pra z.Bajram Ajeti, kjo është e vërteta e që besoj që e dini edhe ju se është nxjerrë një Udhëzim i ri dhe tani jemi duke punuar në atë draft së bashku me zyrën ligjore dhe koordinatorin për bashkëpunim me fshatra dhe lagje urbane, dhe ka një afat ligjor kur duhet t'i harmonizojmë e që besoj se brenda këtij afati do të miratohet Rregullorja në fjalë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, edhe pse kjo është jashtë rendit të ditës, sa i përket çështjes së draft Rregullores për bashkëpunim me fshatra dhe lagje urbane, do të ishte mirë të harmonizohej brenda afatit ligjor dhe të sillej për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Meqë nuk ka këshilltarë tjerë të lajmëruar për të marrë fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, konsideroj se përfunduan diskutimet, sqarimet dhe çështje tjera të nevojshme, andaj e hedh në votim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri u miratua propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në fshatin Lupç i Poshtëm, sipas materialit përkatës të dërguar për shqyrtim në këtë mbledhje.

6. Informatë e Drejtorisë së Arsimit, për përgatitjet për fillimin e vitit shkollorë 2019/2020

z.Agim Blakçori, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit – DKA, e paraqiti informatën në fjalë, ndër të tjera shtoi, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.18/2019 të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë – MASHT, për kalendarin e vitit shkollor 2019/2020, viti shkollor në Komunën e Podujevës ka filluar më 02 shtator 2019. Drejtoria e Arsimit në funksion të përgatitjeve për fillimin e vitit të ri shkollor ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të krijuar kushtet për fillimin me kohë të vitit të ri shkollor në të gjitha shkollat e Komunës së Podujevës, me përjashtim të shkollës “Ali Ajeti” në fshatin Sfeçël e cila ka filluar me 2 ditë vonesë, dhe shkollës “Kadri Kadriu” paralelja e ndarë Dumnicë e Epërme, e cila ka filluar me 5 ditë vonesë për shkak të punimeve që kanë qenë duke u zhvilluar, mirëpo tani mësimi është duke u zhvilluar normalisht në të gjitha shkollat e Komunës së Podujevës. Gjithashtu me kohë janë bërë furnizimet e të gjithë nxënësve me tekste shkollore ku edhe në këtë vite nga MASHT janë siguruar falas tekstet shkollore nga parashkollor deri në klasën e shtatë, kurse për klasën VIII dhe IX nxënësit janë furnizuar me tekstet e nxënësve të viteve paraprake, ndërsa për nxënësit e shkollave të mesme të larta, nxënësve të cilët janë me gjendje jo të mirë ekonomike sociale edhe këtë vit Komuna e Podujevës ka siguruar tekste shkollore falas për ata nxënës.

Me kohë kemi bërë të gjitha përgatitjet dhe kemi siguruar kuadrin profesional për t’i plotësuar nevojat në Komunën e Podujevës ku me kohë janë zhvilluar të gjitha procedurat e konkursit nga një komision profesional duke u bazuar në normat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Po ashtu regjistrimi i nxënësve në klasën e I-rë dhe parafillor gjithashtu është bërë me kohë.

Në muajin qershor të këtij viti Drejtoria e Arsimit, me leje të MASHT ka shpallur konkursin për regjistrimin e nxënësve në klasën e X-të në Gjimnaz dhe në shkollat profesionale, regjistrime të cilat janë bërë nga komisionet profesionale të themeluara në shkolla, normal nën mbikëqyrjen e Drejtorisë së Arsimit dhe MASHT-it – Inspektorati i arsimit të cilët kanë monitoruar këtë proces, çështje për të cilën kemi pasur shumë kujdes sa i përket respektimit të të gjitha kriterëve dhe në bazë të meritokracisë të bëhet edhe regjistrimi i nxënësve, gjë e cila edhe ka ndodhur. Edhe në këtë vit shkollor kemi hapur edhe dy paralele të drejtimit të mjekësisë si paralele të ndara të shkollës “DR. Ali Sokoli” në Prishtinë. Janë një numër i konsiderueshëm i projekteve në infrastrukturën shkollore, jemi në dijeni se kemi nevojë ende ashtu siç jemi në dijeni edhe për investime bukur të mëdha në këtë fushë, por megjithatë ende kemi nevoja. Në këtë vit veç ka përfunduar ndërtimi i objektit të ri “Dituria” në fshatin Llapashticë e Poshtme, janë në përfundim të punimeve të shkollës “Emin Duraku” në fshatin Bajçinë, kurse gjatë vitit 2019 kemi planifikuar dhe besoj se shumë shpejt do të fillojnë punimet edhe për ndërtimin e objektit të ri SHFMU “Elfir Behrami” në fshatin Metehi, pastaj ka filluar ndërtimi i objektit të ri të shkollës “Kadri Kadriu” - paralelja në fshatin Llaushë e Poshtme, presim që të filloj edhe ndërtimi i objektit të ri shkollorë në fshatin Batllavë, në bazë të njoftimeve që kemi nga MASHT.

Gjithashtu janë realizuar disa projekte dhe disa tjera pritet që të përfundojnë gjatë këtij viti, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me përmirësimin e infrastrukturës, çështje të ndryshme nëpër shkolla të ndryshme, qoftë nëpër salla të edukatës fizike apo intervenime në rrethoja dhe përmirësim të infrastrukturës. Pa dashur të zgjati më shumë, vlen të ceket se në funksion të sigurisë së nxënësve në këtë vit shkollor kemi bërë instalimin e kamerave të sigurisë në shkollat e qytetit, projekt i cili besoj se do të vazhdoj edhe në shkolla tjera në vitin e ardhshëm, si dhe për të gjithë nxënësit të cilët kanë distancë të largët nga shtëpia në shkollë dhe për nxënësit me nevoja të veçanta të cilët i vijojnë mësimet në shkollën “Kongresi i Manastirit” në fshatin Gllamnik, kemi siguruar transport

për të gjithë këta nxënës. Për fund, të gjithë nxënësve dhe punëtorëve të arsimit, ju uroj një vit të mbarë shkollor dhe të suksesshëm.

z.Avni Fetahu, theksoi, fillimisht shpresoj që korrektësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit ta ndjekin edhe Drejtorët tjerë koleg të tij sepse është ndër të vetmit i cili është duke respektuar planin e punës që e kemi miratuar dhe i cili i sjellë informatat me kohë, andaj është shembull i mirë për tu ndjekur edhe nga kolegët e tij.

Lidhur me këtë informatë, unë kam dy pyetje, dhe atë;

1-ka të bëjë me zgjatjen e orës së mësimi që është bërë me një Udhëzim Administrativ e që mendoj se është gjë e mirë kjo ngase mundëson realizimin e plan programit për shkak të volumit të orëve tek secili mësimdhënës, mirëpo ka disa specifika që ka ndryshuar ndoshta edhe planin e atyre të cilët udhëtojnë me transport, autobus, kombibus etj, e që mendoj se ka vështirësuar punën në disa shkolla, por që UA përkatës sa jam në dijeni parasheh edhe mundësin e ankesës, andaj mendoj se si Komunë që jemi me 78 vendbanime dhe me disa specifika ndoshta kishte me qenë mirë që të thuhet se aty ku gjen zbatueshmëri ai udhëzim të zbatohet, ndërsa në disa shkolla është paksa problem të realizohet për shkak të transportit dhe largësisë që kanë nxënësit.

2-ka të bëjë me lokalitetin nga vijë unë, a është e përfshirë Lagja Bajgora, në Merdar, për shkak të distancës, çështje kjo e cila ka qenë edhe mediatike, kurse tani shkolla e fshatit Shtedim është duke vepruar vetëm me një ndërrim e që e ka vështirësuar punën sepse në mëngjes një numër i atyre familjeve të asaj lagjeje që janë 13 nxënës, pra a janë të përfshirë në transport ata nxënës.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, Drejtoria e Arsimit sikurse edhe vitin e kaluar, po edhe në këtë vit ka sjellë një dokument me informacione të përgjithshme në lidhje me fillim vitin shkollor 2019/2020, tekst ky i cili nuk është informues dhe nuk e di nëse mund të quhet informatë sepse do të duhej që Ekzekutivi i Komunës, me theks të veçantë Drejtoria e Arsimit ta konsideronte më seriozisht këtë tekst se po edhe ky që është nuk ka paraqitur gjendjen reale që po ndodh në Komunën e Podujevës. Keni shpallur konkursin për plotësimin e kuadrit mësimor por me parregullsi të shumta e që siç dihet Komuna jonë nuk e shikon kualitetin, ka pas persona të cilët fare nuk i janë nënshtruar testimit kurse janë ftuar në intervistë, pastaj zgjedhja e kuadrit mësimor nuk ka përfunduar në tërësi deri më datën 10 shtator 2019, dhe kur kemi parasysh kohën, përgatitjen, ndarjen e orëve të mësimi, shohim se arsimi nuk është prioritet i Komunës.

Është e vërtetë se Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së e ka thënë se nuk duhet të hapet konkurs nëse ka staf të cilët nuk i kanë orët e mjaftueshme, mirëpo duhet të ekzistoj konkursi i brendshëm që aplikojnë për ato orë, kurse ju nuk e keni bërë por i keni hapur sipas dëshirës.

Gjatë vizitave në terren dhe kontakteve me mësimdhënës kemi parë se politizimi i arsimit, jo që ka rënë por është shtuar më shumë në shkollat e Komunës së Podujevës, shembull, edhe pse tani jemi në javën e fundit të shtatorit ka shumë shkolla që ende nuk janë ndarë orët e mësimi zgjedhor, por kjo është duke ndodh për shkak të zgjedhjeve.

Vërejtje tjetër e Grupit të LVV-së është edhe në rastin e regjistrimit të nxënësve në shkollat e mesme, në Ekonomik dhe Gjimnaz, ku edhe pas 20 viteve të çlirimit, Ekzekutivi i Komunës në tërësi nuk e çan kokën lidhur me problemet që po ndodhin në shkollat e mesme si pasojë e përzierjes së nxënësve të shkollave të mesme me ata të fillores, edhe në këtë drejtim kemi shumë ankesa nga vetë prindërit ngase po kanë probleme nxënësit e shkollave fillore me ata të shkollave të mesme. Pastaj probleme dhe vërejtje tjera janë edhe mungesa e bibliotekës, kur dihet se çfarë u është bërë lexuesve Llapjan që 1 vit e 1 muaj pa bibliotekë. Mungesa e këndeve të leximit në shkolla për nxënësit, mungesa e kabineteve për punë praktike të nxënësve e kur e dim se praktika është pjesa më e rëndësishme sidomos e shkollave profesionale e që nxënësit e shkollave të mesme Ekonomike dhe asaj Teknike nuk mund ta realizojnë si shkak i mungesës së kabineteve e

që për vite të tëra janë duke i humbur orët praktike apo mesatarisht i bie 6 orë në javë, për shkak të mungesës së kabineteve përkatëse, çështje e cila si duket nuk përbën shqetësim për Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit pasi gjetja e institucioneve dhe bizneseve për zhvillimin e praktikës për nxënësit e këtyre shkollave nuk hynë në prioritet, madje nxënësit e këtyre dy shkollave lihen të lirë në ditën kur është dashtë ta kryejnë praktikën, e që është baza për drejtimin që e kanë zgjedhur, prandaj në këtë aspekt nxënësit janë duke humbur shumë dhe duhet të bëhet zgjidhje sa më shpejt. Kur keni shkruar për ndërtimin e objekteve shkollore, është për të qeshur sepse më shumë ka premtime se do të bëhet sesa një informatë se pse nuk kanë përfunduar, shembull, thuhet punimet në shkollën “Emin Duraku” është dashur të përfundojnë në shtator por ende nuk kanë përfunduar, pa dhënë shkaqe përse nuk kanë ndodhur, çka po ju dukemi ne këtu, duhet t’ju vie turp që fare nuk jeni serioz.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, konsideroj se informata e Drejtorisë së Arsimit ju është dërguar me kohë dhe keni pas kohë ta analizoni, pastaj edhe Drejtori i Drejtorisë së Arsimit paraprakisht i paraqiti edhe disa informata dhe sqarime shtesë rreth përgatitjeve dhe fillimit të vitit të ri shkollor 2019/2020, andaj meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, e konsideroj të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës.

7. Të ndryshme

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, dëshiroj t’ju njoftoj se në bazë të dispozitave ligjore, në përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB, parashihet të jetë kryesuesi/ja e Komitetit për Komunitete. Jeni në dijeni se ish Kryesuesi i Komitetit për Komunitete dhe njëkohësisht edhe anëtari i KKSB-së, para disa muajve ka ndërruar jetë, kurse në vend të tij tash së fundmi është zgjedhur znj.Albina Avdiu Kryesuese e Komitetit për Komunitete në Komunën e Podujevës, e cila me automatizëm duhet të jetë anëtare në përbërjen e KKSB-së, mirëpo kjo çështje duhet të procedohet përmes Kuvendit përkatësisht duhet të merr mbështetjen nga Kuvendi i Komunës e që besoj se të gjithë jeni në dijeni për këtë proces, andaj a pajtoheni që të bëhet plotësimi i përbërjes së KKSB-së në Komunën e Podujevës me anëtarin e cekur më lartë.

Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri nga anëtarët e Kuvendit të Komunës u mbështet që të plotësohet përbërja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi përkatësisht znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit për Komunitete emërohet anëtare në përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB në Komunën e Podujevës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, dëshiroj të ngriti një pyetje, nuk di tani kush mund të më jap përgjigje sepse Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave shkoi, konkretisht kam dëgjuar por tani të paktën dua të dëgjoj zyrtarisht se a merr pagë nga Komuna e Podujevës ndonjë zyrtar serb i cili nuk jeton në Podujevë por i cili vjen vetëm me datë 01 të çdo muaji dhe e merr pagën. Kam dëgjuar që i ashtuquajtur kryetar për Podujevë, i cili qëndron në Kushumli me kabinetin e tij, por që merr pagë nga Komuna e Podujevës. Pra kjo është pyetje dhe nuk do të thotë që të jepet përgjigje tani për tani.

Kam dëgjuar që ai person vjen këtu, me përcjellje edhe pse nuk është i rrezikuar, e që në seancën e radhës do të kërkoj sërish të informohem se a merr pagë ai person apo jo, si e merr, përse e merr pagën nga buxheti i Komunës së Podujevës.

Duke e uruar anëtarin e re të KKSB, ne nganjëherë po votojmë bllanko për vendime të Komuniteteve, madje edhe pa e ditur se si po vijnë përfaqësuesit e Komuniteteve jo shumicë, po ashtu jemi në dijeni edhe për gjendjen infrastrukture ku ata jetojnë, por që kërkoj nga anëtarja e re e KKSB të bashkëpunon sa më shumë me ne dhe të jemi në gjendje që çka të mundemi t'i ndihmojmë atyre.

Pra rreth pyetjes që parashtrova, Drejtori i DBF z.Isuf Latifi më dëgjoj por shkoi e që sigurisht e dinë më mirë këtë çështje, andaj lus edhe Kryesuesin e Kuvendit nëse mund të informohet, a merr pagë kabineti i ashtuquajturit kryetar paralel i Podujevës, nëse po, pse e merre, dhe me çfarë baze paguhet ai, përgjigje të cilën ndoshta mund të jap edhe Drejtori i Drejtorisë së Administratës. T'ju them të drejtën unë nuk besoj dhe nuk po dëshiroj të besoj se ai person paguhet ashtu siç e ceka, por kam të dhëna që më datën 01 të çdo muaji, në Merdar vjen me përcjellje këtu në Komunë vetëm për të marrë pagën, nëse është kështu atëherë do të shikojmë se çfarë do të bëjmë lidhur me këtë çështje, por të marrim përgjigje zyrtare njëherë.

Po ta përfaqësonte ai person komunitetin Serb, do të ishte shumë në rregull, por nëse paguhet si Kryetar Komune, paralel, njëjtë me Kryetarin e Komunës, unë ju them se duhet të ndërpritet, kush e ndërpre, Republika e Kosovës, ne apo qytetarët do të jetë çështje tjetër. Pra të jepet një përgjigje konkrete dhe e shkurt, po, jo.

z.Gëzim Namani, Drejtor i DA, theksoi, dëshiroj të jap një përgjigje të pjesërishtme lidhur me pyetjen e këshilltarit paraprak, nuk jam në dijeni se ndokush nga strukturat paralele merr pagë, aq më pak se ndokush nga Komuna shkon e merr ndonjë person në Merdar me 01 të çdo muaji dhe e sjellë në Komunë për të marrë pagën. Në të kaluarën, Komuna ka lejuar nganjëherë sigurimin e transportit për përfaqësuesin e Komunitetit Serb në Komitetin për Komunitete dhe në KKSB, i cili ka banuar në fshatin Metergoc-Lagja Sekiraça dhe i cili nuk ka pasur me çka të vie në mbledhje, mirëpo për ndonjë person tjetër nuk kam dijeni nëse shkon ndokush dhe e merr ashtu siç e ceku parafolësi, kështu që pyetja ishte legjitime, dhe do të japim përgjigje pa telashe.

z.Fatmir Rudari, theksoi, dëshiroj të ngriti një shqetësim lidhur me disa ankesa që po bëhen vazhdimisht për emërimin e rrugëve, pra më janë adresuar disa qytetarë lidhur me emërimin e rrugëve që po bëhet, andaj pyes, a është duke i shqyrtuar ato ankesa ndokush dhe a ka ndonjë komision që i shqyrton ato ankesa. Unë jam në dijeni se është votuar njëherë Vendimi me të cilin janë emëruar të gjitha rrugët e Komunës së Podujevës, mirëpo janë disa ankesa që po bëhen vazhdimisht por që nuk po marrin përgjigje, pra nëse ekziston mundësia e dhënies së sqarimeve sot do të ishte mirë përndryshe për këtë çështje të jepen përgjigje - sqarime në seancën e radhës.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, pati disa çështje - pyetje që u ngritën, dhe shpresojmë që në seancën e radhës të jepen sqarimet – përgjigjet përkatëse.

Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi mbledhjen të përfunduar.

Mbledhja përfundoi në ora 12:35

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0075918/19

Podujevë,

23 shtator 2019

Kryesuesi i Kuvendit

Fatmir Gashi